

EPOKA ERE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5611
E enjte, 25 tetor 2018
çmimi 0.40 €

Haradinaj: Shkodra na ka bërë krenarë ndër shekuj

FAQE 2




Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

AKTUALE



LIMAJ ZOTOHET SE DO T'I MARRË PARASYSH KËRKESAT E SBASHK-ut F. 5

MATOSHI KËRKON ZBATIM TË UDHËZIMIT PËR GJOBA NGA INSPEKTORËT KOMUNALË F. 6

KRYQI I KUQ I KOSOVËS DHURON NJË AUTOAMBULANCË PËR KLINIKËN EMERGJENTE F. 7

EKONOMI

ASGJËSOHEN 17 MIJË LODRA QË RREZIKOJNË SHËNDETIN E FËMIJËVE F. 9

DEFICITI TREGTAR I KOSOVËS NË SHTATOR, MBI 257.3 MILIONË EURO F. 9

KULTURË

TRI GRA NGA KOSOVA NË GARË PËR ÇMIMIN OSCAR F. 13

SPORT

MALIQI: DO TË NDRYSHOJË RENDITJA F. 19

FLET PËR "EPOKËN E RE", EKREM MUSTAFA F. 4-5



Do të jem i përkushtuar për vendosjen e rendit dhe zbatimin e ligjit


Ministri i Punëve të Brendshme, Ekrem Mustafa, ka bërë me dije se anëtarësimi i Kosovës në Interpol, mirëmbajtja e aspekteve me ndikim në liberalizimin e vizave, përgjegjësitë në raport me MSA-në janë prioritetet e tij si ministër. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka theksuar se do të jetë i përkushtuar

për realizimin e detyrave të Kosovës drejt përafrimit me Bashkimin Evropian. Mustafa ka pohuar se ndër prioritetet e punës së tij do të jetë luftimi i krimit dhe korrupsionit, luftimi i trafikimit të genieve njerëzore si dhe luftimi i terrorizmit dhe ekstremizmit. Ai ka deklaruar se Ministria e Punëve të Brendshme dhe

të gjitha agjencitë nën menaxhimin e saj janë të përkushtuara për vendosjen e rendit dhe zbatimin e ligjit. Rastin e fundit ku djali të shefit të AKI-së iu gjetën armë dhe narkotikë në veturë ministri Mustafa nuk ka dashur ta komentojë, duke theksuar se janë organet e drejtësisë që do ta thonë fjalën e tyre

MINISTRJA E INTEGRIMIT EVROPIAN (MIE), DHURATA HOXHA, KA TAKUAR NË STRASBURG DISA EURODEPUTETË ME TË CILËT KA BISEDUAR PËR PROCESIN E LIBERALIZIMIT TË VIZAVE

Hoxha në Strasburg kërkon përshpejtimin e vendimmarrjes për vizat



Ministrja e Integrimit Evropian (MIE), Dhurata Hoxha, ka kërkuar të mërkurën prej eurodeputetëve që të procedohet sipas afateve vendimmarrja rreth liberalizimit të vizave për Kosovën. Gjatë vizitës së saj në Strasburg, ku ka takuar disa deputetë të Parlamentit Evropian, ministrja Hoxha ka bërë me dije se Kosova i ka plotësuar të gjitha kërkesat për këtë proces dhe se nuk ka asnjë arsye për shtyrje F. 3

Për nëntë muaj 90 persona humbën jetën në aksidente trafiku

FAQE 7



RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepçisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVE
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Meta kërkon finalizimin e liberalizimit të vizave për Kosovën

TIRANË, 24 TETOR - Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, gjatë vizitës zyrtare në Austri, është takuar me kryetarin e Parlamentit austriak, Wolfgang Sobotka. Gjatë këtij takimi Meta ka thënë se Parlamenti austriak, ashtu si të

gjitha institucionet e tjera të këtij vendi, janë përkrahëse të palëkundura të procesit të integritetit të Shqipërisë dhe rajonit të Ballkanit Perëndimor në BE. Presidenti Meta ka vënë në duke rëndësinë që ka finalizimi i liberal-

izimit të vizave për Kosovën si shteti i vetëm që ende nuk përfiton këtë të drejtë në rajon, edhe pse, sipas tij, tashmë Kosova i ka plotësuar të gjitha standardet e kërkuara në këtë proces. "Takim shumë i mirë me kryetarin e Parlamentit austri-

ak, Wolfgang Sobotka, gjatë vizitës zyrtare në Austri. Mirëprita mbështetjen e fortë për Shqipërinë dhe angazhimin për ta ruajtur rajonin e Evropës Juglindore në qendër të agjendës evropiane", ka thënë Meta.



Kryeministri i Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj, ka qëndruar për vizitë zyrtare në qytetin e Shkodrës

Haradinaj: Shkodra na ka bërë krenarë ndër shekuj

"Jam i emocionuar që jam në Shkodër, në adresën e kombit, në adresën e shqiptarisë, në vendin i cili na ka bërë krenarë dhe na ka bërë të mburremi ndër shekuj për atë që jemi shqiptarë", tha kryeministri Haradinaj



SHKODËR, 24 TETOR - Kryeministri i Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj, gjatë vizitës së tij zyrtare në Shkodër, është prituri të mërkurën nga kryetarja e Bashkisë së Shkodrës, Voltana Ademi, me bashkëpunëtorë. Vizitën zyrtare, kryeministri Haradinaj, i shoqëruar edhe nga kryetarja Ademi, e ka nisur me homazhe te shtatorja e heroit kombëtar Isa Boletini. Me këtë rast kryeministri Haradinaj tha se ndihet i emocionuar që po e viziton qytetin e Shkodrës, të cilin e ka quajtur

adresë të të gjithë shqiptarëve. "Jam i emocionuar që jam në Shkodër, në adresën e kombit, në adresën e shqiptarisë, në vendin i cili na ka bërë krenarë dhe na ka bërë të mburremi ndër shekuj për atë që jemi shqiptarë", tha kryeministri Haradinaj, duke falënderuar kryetaren Voltana Ademi dhe të gjithë bashkëpunëtorët e tjerë për pritjen, dhe shtoi se ndihet i vlerësuar me shpalljen "Qytetar Nderi" nga Bashkia e Shkodrës në vitin 2017. Ndërkaq kryetarja e Bashkisë së Shkodrës, Voltana Ademi, i ka

uruar mirëseardhje dhe e ka falënderuar kryeministrin Haradinaj, që ka zgjedhur për ta vizituar qytetin e tyre, Shkodrën. "Unë ju falënderoj për vizitën dhe shpresoj se do ta kemi mundësinë të marrim disa iniciativa edhe në kuadër të Vitit Mbarëkombëtar të Gjergj Kastriotit - Skënderbeut dhe të disa ngjarjeve kombëtare për Shqipërinë dhe Kosovën", tha kryetarja Ademi, duke e cilësuar vizitën e kryeministrit Haradinaj historike për qytetin e Shkodrës. Më pas, kryeministri Haradinaj është prituri në Bashkinë e Shkodrës nga kryetarja Voltana Ademi me bashkëpunëtorë, me

të cilën ka biseduar rreth bashkëpunimit institucional të nivelit qendror dhe atij lokal ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë. Ndër temat që janë biseduar gjatë këtij takimi kanë qenë zhvillimi i turizmit, si dhe shkëmbimi i përvojave në këtë fushë. Po ashtu, është biseduar edhe për bashkëpunimin në fushën e kulturës, si dhe fusha të tjera të interesit reciprok. Gjatë këtij takimi është propozuar edhe renovimi i shtëpisë muze të Komitetit "Mbrotjtja Kombëtare e Kosovës", për të cilën u tha se vlerat e trashëgimisë kulturore dhe monumenteve historike do

ta kenë vëmendjen e institucioneve të të dy vendeve. Më tej, kryeministri Haradinaj ka vizituar edhe Muzeun Kombëtar të Fotografisë, "Marubi", ku nga drejtori i këtij institucioni, Luçjan Bedeni, është njoftuar për vlerat e koleksionit fotografik përmes të cilit janë dokumentuar çaste të rëndësishme të jetës shoqërore, kulturore, sportive dhe politike përgjatë historisë. "Jam i kënaqur që jam në Shkodër, një vend i mirë, i njerëzve të mirë dhe vlerë e mirë e shqiptarëve. Me këtë ndjenjë po largohem nga Shkodra", tha kryeministri Haradinaj në fund të vizitës.



Bushati: Shqipëria, rast unik për modernizimin e shoqërisë

TIRANË, 24 TETOR - Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme të Shqipërisë, Ditmir Bushati, mori pjesë në Forumin e Sigurisë së Varshavës. Gjatë këtij Forumi, ministri Bushati mbajti fjalën si panelist në sesionin ministerial me temë "Ta gjejmë drejtimin në kohë të vështira, BE-ja dhe Ballkani Perëndimor", ku u diskutuan disa prej çështjeve që lidhen me

procesin e integritetit evropian të Ballkanit Perëndimor, pritshmëritë dhe të ardhmen e procesit të Berlinit, në kuadër të Samitit që do të mbahet në Poloni. Në fjalën e tij, ministri Bushati e vuri theksin te procesi i integritetit evropian të Ballkanit Perëndimor, përmes konsolidimit të reformave, veçanërisht në fushën e sundimit të

ligjit. "Ne po përfjetojmë procesin e zgjerimit nëpërmjet reformimit të fushës së sundimit të ligjit si një prioritet i Ballkanit. Sundimi i ligjit është parakusht për ndërtimin e një shoqërie të qëndrueshme dhe për zhvillimin ekonomik. Shqipëria është rast unik për reformën e saj në drejtësi jo vetëm për integritimin në BE, por edhe për modernizimin e shoqërisë", nënvizoi ai.

Gjatë punimeve të këtij forumi, ministri Bushati zhvilloi një takim me ministrin e Jashtëm të Republikës së Polonisë, Jacek Czaputowicz. Ministrat vlerësuan marrëdhëniet shumë të mira institucionale dhe politike midis dy vendeve dhe shprehën interesin për shtimin e dialogut politik në kuadrin dypalësh dhe shumëpalësh. Ministri Bushati vlerësoi



angazhimin e Polonisë për organizimin e Samitit të radhës të Procesit të Berlinit si një shprehje e angazhimit të Polonisë me BP dhe procesin e zgjerimit të BE-së.

Ministrja e Integritimit Evropian (MIE), Dhurata Hoxha, ka takuar në Strasburg disa eurodeputetë me të cilët ka biseduar për procesin e liberalizimit të vizave

Hoxha në Strasburg kërkon përrshpejtimin e vendimmarrjes për vizat

Ministrja e Integritimit Evropian (MIE), Dhurata Hoxha, ka kërkuar të mërkurën prej eurodeputetëve që të procedohet sipas afateve vendimmarrja rreth liberalizimit të vizave për Kosovën. Gjatë vizitës së saj në Strasburg, ku ka takuar disa deputetë të Parlamentit Evropian, ministrja Hoxha ka bërë me dije se Kosova i ka plotësuar të gjitha kërkesat për këtë proces dhe se nuk ka asnjë arsye për shtyrje

Zëvendëskryeministri Hoxhaj kërkon mbështetjen e Gjermanisë dhe Austrisë për vizat

Zëvendëskryeministri Enver Hoxhaj ka takuar të mërkurën ambasadorin e Gjermanisë, Christian Heldt dhe ambasadorin e Austrisë, Gernot Pfandler, me të cilët ka diskutuar për perspektivën evropiane të Kosovës. Në takimet e ndara me ambasadorët evropianë, Hoxhaj ka kërkuar mbështetjen e Gjermanisë dhe të Austrisë për liberalizimin e vizave për qytetarët e Kosovës. Sipas tij, Kosova ka përbushur të gjitha kushtet e parapara dhe se shtetet anëtare duhet ta njohin dhe ta pranojnë këtë progres

duke dhënë dritën e gjelbër për lëvizjen e lirë të kosovarëve. "Me ambasadorin e Gjermanisë, Christian Heldt dhe të Austrisë, Gernot Pfandler, diskutuam sot në takime të ndara për perspektivën evropiane të Kosovës, me theks të veçantë për liberalizimin e vizave për qytetarët tanë. Theksova se Kosova ka përbushur të gjitha kushtet e parapara dhe se shtetet anëtare duhet ta njohin dhe ta pranojnë këtë progres duke dhënë dritën e gjelbër për lëvizjen e lirë të kosovarëve. "Me ambasadorin e Gjermanisë, Christian Heldt dhe të Austrisë, Gernot Pfandler, diskutuam sot në takime të ndara për perspektivën evropiane të Kosovës, me theks të veçantë për liberalizimin e vizave për qytetarët tanë. Theksova se Kosova ka përbushur të gjitha kushtet e parapara dhe se shtetet anëtare duhet ta njohin dhe ta pranojnë këtë progres

itës në Strasburg ka takuar kryesuesin e Komisionit për Punë të Jashtme, Siguri, Mbrojtje dhe të Drejtat e Njeriut (AFET), njëherësh raportues pranë Parlamentit Evropian, David McAllister, me të cilin ka diskutuar për liberalizimin e vizave. Ajo ka kërkuar përkrahje për liberalizimin e vizave nga McAllister dhe ka theksuar se Kosova ka zbatuar rekomandimet për liberalizimin e vizave, duke zbatuar ato një nga një nga udhërrëfyesi për liberalizim.

Ministrja ka vlerësuar lart angazhimin e McAllister si dhe të Komisionit AFET për inkurajimin e procesit të liberalizimit të vizave për shtetasit e Kosovës, me theks të veçantë të arriturat për përbushjen e kushteve nga udhërrëfyesi. Sipas ministres, fushata e filluar rreth liberalizimit ka hasur në mirëkuptim të qytetarët, duke marrë informacionet e duhura për respektimin e procesit si dhe të mirat e lëvizjes së lirë. Ministrja Hoxha ka kërkuar nga McAllister që të procedohet sipas afateve dhe lëvizja e lirë të mos bëhet pengesë për zhvillimin e Kosovës dhe qytetarëve të saj. Ajo ka thënë se është radha e BE-së ta kryejë pjesën e vet pasi që Kosova i ka plotësuar kriteret dhe të dëshmojë se është partnerë kredibile.

**EPOKA
ERE****Muhamet KOCI**

PRISHTINË 24 TETOR - Ministrja e Integritimit Evropian (MIE), Dhurata Hoxha, ka kërkuar nga eurodeputetët që të mos zvarritet procesi i vendimmarrjes rreth liberalizimit të vizave për qytetarët e Kosovës. Teksa ka takuar të mërkurën në Strasburg, Igor Sholtes, raportues për Kosovën në Parlamentin Evropian, dhe Eduard Kukan, eurodeputetët nga Sllovakia, kryesues i delegacionit të Parlamentit Evropian për Serbi si dhe përfaqësues i grupit të partive të djathta për Ballkanin Perëndimor, ministrja Hoxha ka thënë se Kosova i ka plotësuar të gjitha kriteret për këtë proces dhe nuk ka arsye për shtyrje të vendimit. "Kosova dhe qytetarët e saj padrejtësisht janë privuar nga lëvizja e lirë, duke mbetur i vetmi vend në rajon që nuk gëzon regjimin pa viza me

vendet e Zonës së Shengenit. Lëvizja e lirë do ta rrisë cilësinë e jetës së qytetarëve tanë", ka thënë ministrja Hoxha në takim me raportuesin për Kosovën në Parlamentin Evropian, Igor Sholtes.

Ajo ka falënderuar Sholtes për përkushtimin e tij për liberalizimin e vizave dhe për përkrahjen e pakursyer në këtë proces. "Ne kemi plotësuar të gjitha kriteret dhe tani është radha e BE-së dhe shteteve anëtare që ta kryejnë pjesën e vet të punës. Ne kemi treguar rezultate, kemi vepruar sipas udhërrëfyesit. BE-ja duhet të veprojë tani pa humbur kohë dhe ta mundësojë lëvizjen e lirë për qytetarët tanë", ka thënë Hoxha.

Ndërsa Igor Sholtes ka inkurajuar punën e ministres Hoxha dhe të Kosovës në tërësi, duke theksuar se shpreson që procedurat e mbetura për heqjen e vizave për qytetarët e Kosovës, e që janë në

nivel të BE-së, do të kryhen brenda afateve. "Shpresoj se shtetet anëtare do ta ndjekin shembullin e Parlamentit Evropian dhe do t'ia japin dritën e gjelbër regjimit pa viza sa më shpejt që është e mundur", është shprehur ai. Pas takimit me Sholtes, ministrja Dhurata Hoxha ka takuar në Strasburg edhe eurodeputetin Eduard Kukan. Hoxha e ka falënderuar Kukanin për vlerësimin ndaj Ballkanit Perëndimor, në veçanti për të arriturat e Kosovës,

për kushtet e realizuara për lëvizjen e lirë, duke vënë në pah se liberalizimi i vizave është në duart e shteteve të BE-së, ku Komisioni Evropian e ka konfirmuar se Kosova ka përbushur kushtet lidhur me liberalizimin e vizave, të përcaktuara me udhërrëfyesi. Kukan ka theksuar se Ballkani Perëndimor është brenda strategjisë dhe planit të zgjerimit të Bashkimit Evropian. Ministrja e Integritimit Evropian, Dhurata Hoxha, në fillim të viz-



Policia arreston një person për keqpërdorim të pozitës

PRISHTINË, 24 TETOR (ER) - Policia e Kosovës, respektivisht hetuesit policorë kundër krim-it ekonomik dhe korrupsionit, përmes masave të fshehta të vëzhgimit, pas një pune të

gjatë hetimore dhe profesionale, më 23. 10. 2018 kanë arrestuar një person të dyshuar (inspektor të ATK-së) nga rajoni i Ferizajt, nën dyshimin e bazuar se i njëjti ka

kryer veprën penale "Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar" nga neni 422 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës. Personi i arrestuar dyshohej se, duke keqpër-

dorur pozitën apo autoritetin zyrtar gjatë periudhës kohore 2016-2018, ka ushtruar ndikim në biznese të ndryshme të rajonit të Ferizajt. Lidhur me këtë rast njësitet relevante

policore kanë ndërmarrë të gjitha veprimet hetimore, ku me autorizim të prokurorit kompetent të njëjtë i është caktuar masa e ndalimit policor prej 48 orësh.

Flet për "Epokën e re", Ekrem Mustafa

Do të jem i përkushtuar për vendo

Ministri i Punëve të Brendshme, Ekrem Mustafa, ka bërë me dije se anëtarësimi i Kosovës në Interpol, mirëmbajtja e aspekteve me ndikim në liberalizimin e vizave, përgjegjësitë në raport me MSA-në janë prioritetet e tij si ministër. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka theksuar se do të jetë i përkushtuar për realizimin e detyrave të Kosovës drejt përafrimit me Bashkimin Evropian. Mustafa ka pohuar se ndër prioritetet e punës së tij do të jetë luftimi i krimit dhe korrupsionit, luftimi i trafikimit të qenieve njerëzore si dhe luftimi i terrorizmit dhe ekstremizmit. Ai ka deklaruar se Ministria e Punëve të Brendshme dhe të gjitha agjencitë nën menaxhimin e saj janë të përkushtuar për vendosjen e rendit dhe zbatimin e ligjit. Rastin e fundit ku djalit të shefit të AKI-së iu gjetën armë dhe narkotikë në veturë ministri Mustafa nuk ka dashur ta komentojë, duke theksuar se janë organet e drejtësisë që do ta thonë fjalën e tyre



EPOKA E RE **Shqipe HETEMI**

PRISHTINË, 24 TETOR - Ministri i Punëve të Brendshme (MPB), Ekrem Mustafa, ka thënë të mërkurën se anëtarësimi i Kosovës në Interpol, mirëmbajtja e aspekteve me ndikim në liberalizimin e vizave për qytetarët tanë si dhe përgjegjësitë e kësaj ministrie në raport me MSA-në janë prioritetet e punës së tij. Po ashtu, ai është zotur se prioritet kryesor do ta ketë luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit. "Ndër prioritetet e punës së dikasterit qeveritar i cili më është besuar do të jetë lufta kundër krimit të organizuar, me theks të veçantë luftimi i korrupsionit, lufta kundër narkotikëve dhe luftimi kundër trafikimit të qenieve njerëzore. Këto do të jenë prioritetet në rrafshin e sundimit të ligjit por, natyrisht, nuk do të ndalemi vetëm këtu. Do t'i luftojmë të gjitha format e terrorizmit dhe të ekstremizmave radikalë", ka deklaruar Mustafa, duke shtuar se MPB-ja dhe të gjitha agjencitë nën menaxhimin e saj janë të përkushtuara për vendosjen e rendit dhe zbatimin e ligjit.

Ai ka theksuar se një ambient i sigurt për qytetarët, pavarësisht prej përkatësisë së tyre etnike apo fetare, mbetet përkushtim permanent i punës së tij dhe dikasterit që drejton. "Si ministër ju siguroj se angazhimi dhe rezultatet nuk do të mungojnë asnjëherë. Sikurse ju thashë në fillim, luftimi i krimit dhe korrupsionit janë prioritetet e MPB-së. Pa ndërhyrë në fushën operationale të policisë dhe agjencive të tjera, MPB-ja do të zhvil-

lojë politika adekuate që do të mundësojnë sukses. Rezultatet mund të mos jenë të dukshme menjëherë, po ju siguroj se po punohet në drejtimin e duhur dhe shtimi i dinamikës së angazhimeve do të vërehet gradualisht nga qytetarët në shërbim të të cilëve jemi", është shprehur Mustafa.

Ai ka bërë me dije se ka një angazhim të jashtëzakonshëm dhe të koordinuar mirë ndërmjet institucioneve për anëtarësimin e Kosovës në Interpol. Sipas Mustafës, për këtë çështje janë angazhuar ekspertë të cilët me lobimin e tyre dhe argumentet që ofrojnë po përmbysin pretendimet se mund të ketë rezerva për pranimin e Kosovës. "Që nga ardhja ime në detyrë jam informuar lidhur me angazhimet e të gjithë aktorëve relevantë të inkuadruar në lobimin për Interpol, e më pas edhe jam inkuadruar në këto aktivitete së bashku me kabinetin tim. Anëtarësimi në Interpol nuk është thjesht një hap tutje rreth rrumbullakimit të subjektivitetit ndërkombëtar të Kosovës, por ai prek aspekte të sigurisë dhe të bashkëpunimit ndërshtetëror në këtë drejtim", ka thënë Mustafa.

"Epoka e re": Z. Mustafa, para një jave keni ardhur në krye të Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB). Cilat do të jenë prioritetet tuaja?

Mustafa: Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) ka mision kujdesin për sundimin e ligjit dhe sigurinë publike. Më lejoni t'ju informoj se ndër prioritetet e punës së dikasterit qeveritar i cili më është besuar, do të jetë lufta kundër krimit të orga-

nizuar, me theks të veçantë luftimi i korrupsionit, lufta kundër narkotikëve dhe luftimi kundër trafikimit të qenieve njerëzore. Këto do të jenë prioritetet në rrafshin e sundimit të ligjit, por natyrisht nuk do të ndalemi vetëm këtu. Do t'i luftojmë të gjitha format e terrorizmit dhe të ekstremizmave radikalë. Një segment tjetër i prioritetëve ka të bëjë me detyrat që kemi para nesh në rrafshin ndërkombëtar apo me implikime ndërkombëtare e ku MPB-ja luan rol vendimtar. Anëtarësimi i Kosovës në Interpol, mirëmbajtja e aspekteve me ndikim në liberalizimin e vizave për qytetarët tanë, apo edhe përgjegjësitë tona në raport me MSA-në, janë prioritetet në këtë rrafsh. Ministria e Punëve të Brendshme do të vazhdojë të jetë e përkushtuar për realizimin e detyrave në

rrugën tonë të trasuar drejt përafrimit me Bashkimin Evropian dhe përgjithësisht në rrugëtimin e Kosovës për subjektivitet të plotë në kuadër të sistemit politik ndërkombëtar. Sot bota është shumë dinamike. Relacionet ndërkombëtare nuk varen thjesht nga dikasteret të cilët kanë përgjegjësi primare relacionet me shtetet e tjera. Absolutisht i takon çdo dikasteri veç e veç që në kuadër të fushëveprimit të vet ta lehtësojë rrugëtimin ndërkombëtar të shtetit tonë.

"Epoka e re": Kjo ministri për një vit ka ndërruar dy ministra. Duke pasur parasysh se Kosova vuan nga mungesa e rendit dhe ligjit, çfarë do të bëni ju si ministër në këtë drejtim?

Mustafa: Nuk më takon ta komentoj ndërrimin e mëparshëm të ministrave.

Kosova po konsolidon me sukses institucionet dhe agjencitë, puna e të cilave ka ndikim të drejtpërdrejtë në mbarëvajtjen e rendit dhe sundimit e ligjit. Sigurisht, ne nuk duhet të harrojmë se vendi ynë ka kaluar nëpër një periudhë mjaft të ndjeshme duke u nisur nga lufta, pastaj periudha e pasluftës e deri tani kur u bënë dhjetë vjet që nga shpallja e pavarësisë. Pavarësisht prej kësaj, me përgjegjësi them se Policia e Kosovës apo edhe agjencitë e tjera të cilat funksionojnë nën autoritetin e MPB-së, spikaten nga një profesionalizëm i duhur. Me shkallën e profesionalizimit dallohemi në regjion. Në gjithë këtë duhet t'u jemi përherë mirënjohës miqve tanë ndërkombëtarë. Gjithmonë mund të ketë vend për përmirësime, kurse përmirësimet

sjen e rendit dhe zbatimin e ligjit

mund të realizohen vetëm nëse kemi qasje të saktë analitike në proceset të cilat janë në zhvillim. Unë si ministër jam zotuar para kryeministrit si dhe zotohem para qytetarëve të vendit, se do ta kem në fokus përmirësimin e aspekteve ku mund të ketë pasur ngecje në të kaluarën. Lidhur me këtë që tani kam dhënë udhëzime të qarta se si të veprohet ashtu që edhe rezultatet të mos vonojnë. Kabineti im është në fazën e grumbullimit të informacionit lidhur me procese mjaft të rëndësishme në të cilat ndodhemi dhe ku shumëçka varet nga performanca e Ministrisë së Punëve Brendshme. Stafit të cilin e drejtoj i janë dhënë instruksione të qarta që të jenë në shkallën më të lartë të përgjegjësive.

"Epoka e re": Si e komenton skandalin e fundit ku djali i shefit të AKI-së, Shpend Maxhuni, është arrestuar meqë i është gjetur armë dhe narkotikë. Çfarë veprimesh keni marrë ju?

Mustafa: Policia realizon detyrat dhe përgjegjësitë që ka. U takon organeve kompetente të drejtësisë të merren me rastet e proceduara nga policia. Natyrisht kam përcjellë edhe reagimin medial lidhur me rastin apo edhe komentet e ndryshme që prodhon diskursi ndërmjet partive politike në vend. Rikujtoj se Kosova udhëhiqet nga ligje demokratike dhe janë organet e drejtësisë ato që vërtetojnë fajësinë apo jo.

"Epoka e re": Ndonëse në vazhdimësi drejtuesit e institucioneve dhe ata të sistemit të

drejtësisë thonë se prioritet kryesor i vendit është luftimi i krimit dhe korrupsionit, megjithatë nuk po ka rezultate të prekshme. Gjatë mandatit tuaj mund të presim më shumë angazhim në këtë aspekt?

Mustafa: Ministria e Punëve të Brendshme dhe të gjitha agjencitë nën menaxhimin e saj janë të përkushtuar për vendosjen e rendit dhe zbatimin e ligjit. Një ambient i sigurt për qytetarët tanë, pavarësisht prej përkatësisë së tyre etnike apo fetare, mbetet përkushtim permanent i punës së institucionit, drejtimi i të cilit më është besuar. Si ministër ju siguroj që angazhimi dhe rezultatet nuk do të mungojnë asnjëherë. Sikurse ju thashë në fillim, luftimi i krimit dhe korrupsionit

janë prioritet të MPB-së. Pa ndërhyrë në fushën operationale të policisë dhe agjencive të tjera, MPB-ja do të zhvillojë politika adekuate që do të mundësojnë sukses. Rezultatet mund të mos jenë të dukshme menjëherë, po ju siguroj se po punohet në drejtimin e duhur dhe shtimi i dinamikës së angazhimeve do të vërehet gradualisht nga qytetarët në shërbim të të cilëve jemi.

"Epoka e re": Muajin tjetër Kosova do të përballlet me betejën për anëtarësim në Interpol. Keni siguruar mbështetjen e nevojshme që shteti ynë të bëhet pjesë e kësaj organizate të rëndësishme?

Mustafa: Ka një angazhim të jashtëzakonshëm dhe mirë të

koordinuar ndërmjet ministrive, Policisë së Kosovës dhe institucioneve të tjera. Janë angazhuar ekspertë të cilët me lobimin e tyre dhe argumentet që ofrojnë, po përmbysin pretendimet e ndryshme nga zëra të caktuar të cilët mund të kenë rezerva lidhur me pranimin e Kosovës në Interpol. Që nga ardhja ime në detyrë fillimisht jam informuar lidhur me angazhimet e të gjithë aktorëve relevantë të inkuadruar në lobimin për Interpol, më pas edhe jam inkuadruar në këto aktivitete së bashku me kabinetin tim. Anëtarësimi në Interpol nuk është thjesht një hap tutje rreth rrumbullakimit të subjektivitetit ndërkombëtar të Kosovës por ai, para së gjithash, prek aspekte të sigurisë dhe të bashkëpunimit ndërshtetëror në këtë drejtim. Pjesë e menjëhershme e agjendës sime janë kontaktet me përfaqësues ndërkombëtarë, përfshirë këtu edhe atashetë policore në kuadër të misioneve diplomatike në Kosovë. Janë dhënë garanci të forta nga shtete të ndryshme, se jo vetëm që do ta japin votën e tyre pro anëtarësimit në Interpol, por do të shohin tutje edhe mundësitë e lobimit ndër anëtarë të tjerë. Bashkëpunimi ndërmjet policive është garanci që në botë nuk do të lejohen 'vrime të zeza' në të cilat pamundësohet qasja e Interpolit. Secili shtet anëtar në Interpol nuk duhet ta shikojë anëtarësimin vetëm si obligim karshi sigurisë ndërkombëtare, por edhe të trajtojë qartë përfitimet dhe përparësitë që krijohen për sigurinë kombëtare dhe për sundimin e rendit dhe ligjit brenda shtetit.

Limaj zotohet se do t'i marrë parasysh kërkesat e SBASHK-ut

PRISHTINË, 24 TETOR (ER) - Zëvendëskryeministri i Kosovës, Fatmir Limaj, dhe ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, kanë pritur të mërkurën në takim përfaqësues të Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (BASHK). Limaj i ka inkurajuar përfaqësuesit e SBASHK-ut që të jenë pjesë përbërëse e të gjitha institucioneve këshillëdhënëse dhe hartimit të strategjive në funksion të përmirësimit të gjendjes së arsimit në Kosovë.

Ndërsa ministri Bytyqi ka thënë se do të trajtojë çdo kërkesë që vjen nga SBASHK-u.

Bytyqi ka thënë se ministria të cilën ai e drejton mbetet e përkushtuar për rritjen e cilësisë në arsim në të gjitha nivelet. Limaj dhe Bytyqi janë zotuar se do t'i marrin parasysh kërkesat e SBASHK-ut dhe do ta vazhdojnë bashkëpunimin e tyre.

Ndërsa Rrahman Jasharaj, kryetar i SBASHK-ut, ka ngritur disa shqetësime lidhur me Projektligjin për mësimdhënësit e viteve '90 dhe për Projektligjin për pagat, për të cilin ka thënë se është diskriminues për mësimdhënësit. Ai ka kërkuar ndihmën e Qeverisë që gjatë shqyrtimit në Kuvend të këtij projektligji të merren parasysh kërkesat e tyre.



Thaçi reagon rreth përleshjes së vëllait të vet: Rasti të trajtohet në përputhje me ligjin

PRISHTINË, 14 TETOR (ER) - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka reagu rreth incidentit ku ishte i përfshirë vëllai i tij, Gani Thaçi. Sipas policisë, përleshja fizike kishte ndodhur mes tre personave, njëri nga ta vëllai i presidentit. Incidenti kishte ndodhur në selinë e Byrosë Kosovare të Sigurimeve ku punon Gani

Thaçi. Presidenti Thaçi përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook" ka shkruar se është i njoftuar për përfshirjen e të vëllait në një përleshje fizike. "Jam njoftuar për përfshirjen e vëllait tim në një përleshje sporadike fizike. Asnjëherë nuk do ta arsyetoj asnjë veprim të kundërligjshëm të askujt, aq më tepër në një rast si ky. Të qenit

familjar i një zyrtari të lartë nuk nënkupton imunitet dhe amnisti për askënd. Përkundrazi. Përgjegjësia është individuale. I ftoj organet e rendit që ta trajtojnë rastin në përputhje me ligjin. Vetëm kështu ndërtojmë shtet ligjor, në të cilin të gjithë jemi të barabartë para ligjit dhe drejtësisë", ka shkruar Thaçi.



Matoshi kërkon zbatim të udhëzimit për gjoba nga inspektorët komunalë



EPOKA
ERE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 24 TETOR - Ministri i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Fatmir Matoshi, së bashku me sekretarin Arben Çitaku, drejtorin e Departamentit të Inspektoratit, Bedri Halimi, të mërkurën janë takuar me drejtorët dhe inspektorët komunalë të Republikës së Kosovës. Gjatë këtij takimi ministri Matoshi i ka

njoftuar drejtorët dhe inspektorët komunalë për Udhëzimin Administrativ për Gjoba Mandatore. "Jemi këtu së bashku, në një takim koordinues, për të lidhur një bashkëpunim nga sot e tutje në zbatim të Udhëzimit Administrativ Nr. 6/2018 për ndëshkimet me Gjoba Mandatore për ata që hedhin mbeturina në vendet që nuk janë të lejuara", ka thënë ministri Matoshi.

Ai ka treguar se Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe aktorët e tjerë institucionalë bashkërisht do ta zbatojnë këtë udhëzim në të mirë të qytetarëve dhe mjedisit. "Jemi të përkushtuar si ministri dhe besoj, bashkërisht me komunat dhe Policinë e Kosovës, që ky Udhëzim Administrativ të gjejë zbatim të plotë në gjithë territorin e Republikës së Kosovës", ka thënë Matoshi.

I pari i MMPH-së, Matoshi para inspektorëve komunalë ka theksuar se janë ata që me vullnet mund ta zbatojnë dhe jetësojnë Udhëzimin Administrativ për Gjoba Mandatore. "Udhëzimi Administrativ për Gjoba Mandatore ka tre mekanizma nga të cilët do të zbatohet. Në rend të parë nga inspektorët e MMPH-së, inspektorët komunalë të mjedisit ose inspektorët e tjerë të autorizuar si dhe nga Policia e Kosovës.

Jemi tre mekanizma që bashkërisht mund ta bëjmë këtë udhëzim të zbatueshëm", ka pohuar Matoshi.

Udhëzimi Administrativ për Gjobat Mandatore parashihet ndëshkime me gjoba mandatore për personat fizikë dhe juridikë të cilët hedhin mbeturina jashtë vendeve të caktuara për hedhjen e tyre. Vlera e gjobës mandatore, varësisht prej veprimit ndëshkues, do të jetë prej 20 deri në 100 euro.

Ministria e Infrastrukturës investon mbi 2 milionë euro në Rekë të Keqe të Gjakovës

GJAKOVË, 24 TETOR (ER) - Ministri i Infrastrukturës, Pal Lekaj, bashkë me kryetarin e Gjakovës, Ardian Gjini dhe deputeten Teuta Haxhiu, të mërkurën inauguroi rrugën Gjakovë - Ponoshec dhe mori pjesë në fillimin e punimeve në rrugën Smolicë - Nivokaz. Rikonstruimi i rrugës Gjakovë - Ponoshec, me gjatësi mbi 11 kilometra, ka kushtuar mbi 800 mijë euro, ndërsa rruga Junik - Ponoshec, e gjatë mbi tetë kilometra, do të riparohet me kosto mbi 25 mijë euro. Rruga e re Smolicë - Nivokaz, me gjatësi gjashtë kilometra, do t'i kushtojë Ministrisë së

Infrastrukturës rreth 730 mijë euro. Edhe në urën e Rekës së Keqe, e cila ka gjatësi mbi 67 metra dhe kosto mbi 500 mijë euro, po punohet me intensitet të shtuar në mënyrë që banorët e fshatrave të kësaj ane të lidhen me qytetin e Gjakovës. Ministri Lekaj, duke u prononcuar para medieve, ka thënë se këto rrugë janë të rëndësishme, pasi lidhin dy shtetet shqiptare dhe se ky është mesazh që Qeveria e udhëhequr nga Haradinaj dhe MI-ja po i kryejnë punët e veta. I pari i dikasterit të infrastrukturës ka potencuar se ky vit është i suksesit ngaqë po

investohet ngado në infrastrukturë me standarde të larta. Ai ka thënë se këto nuk do të jenë projektet e vetme për Gjakovën dhe komunat e vendit, meqë me investime në nivelin lokal ndihmohet zhvillimi ekonomik, lëvizja e lirë e qytetarëve dhe e mallrave.

Kurse kryetari i Gjakovës, Ardian Gjini, duke falënderuar ministrin Pal Lekaj dhe MI-në për mbështetjen e madhe dhe të shpejtë për kompletimin e këtyre projekteve, tha se këto projekte janë për qytetarët dhe tregues i mirë se zotimet e dhëna nga ministri Lekaj dhe ai si kryetar po bëhen realitet.



Për nëntë muaj 90 persona humbën jetën në aksidente trafiku

Sipas statistikave të Policisë së Kosovës, në periudhën janar - shtator të këtij viti 90 persona kanë humbur jetën si pasojë e aksidenteve në komunikacionin rrugor, prej të cilëve 17 këmbësorë, 35 shoferë dhe 38 pasagjerë

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 24 TETOR - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) është duke përcjell në mënyrë të vazhdueshme situatën epidemiologjike të aksidenteve në trafik. Sipas statistikave të Policisë së Kosovës, në periudhën janar - shtator të këtij viti, 90 persona kanë humbur jetën si pasojë e aksidenteve në komunikacionin rrugor, prej të cilëve 17 këmbësorë, 35 shoferë dhe 38 pasagjerë. Ky institut vite me radhë ka shprehur shqetësimin lidhur me numrin e madh të aksidenteve në trafik, ku si pasojë kanë gjetur vdekjen qindra persona që paraqesin shifra alarmante dhe shumë shqetësuese, pasi shumica e viktimave janë këmbësorë. "Deri tani është ndërmarrë shumë pak për parandalimin e tyre. Shkaqet janë të ndryshme, por sigurisht se faktori njeri është më i shpeshtë, pasi nuk janë duke u respektuar rregullat e përgjithshme në trafik, nga manipulimi i pasigurt me automjetet, tejkalimi i shpejtësisë, mosm-

bajtja e distancës, mosrespektimi i shenjave të trafikut dhe mospërshtatja e kushteve të rrugës, përdorimi i shpeshtë i telefonave mobilë, vozitja nën ndikimin e alkoolit, substancave narkotike, ndikimi i lodhjes apo pagjumësisë, trajnimi joserioz gjatë dhënies së provimit për shofer, por duke mos munguar as faktori rrugë dhe automjetet ngaqë ende në shumë vende mungojnë shenjat e komunikacionit dhe veturat e vjetra me mangësi të shumta teknike, ku infrastruktura është problematike dhe drejtuesit e mjeteve janë të pakujdesshëm gjatë vozitjes", është thënë në njoftimin e IKShPK-së. Instituti në fjalë ka vlerësuar se qytetarët e Republikës së Kosovës janë të kërcënuar nga aksidentet e trafikut rrugor. "Tek autorët e aksidenteve vërehet mungesë e edukatës qytetare për rregullat e qarkullimit të këmbësorëve dhe të automjeteve, mosdhënien e përparësive në komunikacion, mes të tjerash, si persona ego-centrikë, të prirë të perceptojnë se bota sillet vetëm rreth tyre, vështirë ta shohin rrethin dhe t'i pranojnë të tjerët, ku veten e per-



ceptojnë në pedestalin e kontrollit absolut ndaj të tjerëve", është thënë në këtë njoftim. Me këtë rast, IKShPK-ja ka rekomanduar përpilimin e një plani të veprimit për parandalimin e aksidenteve dhe aprovimin me procedura urgjente nga Kuvendi i Kosovës dhe zbatimin me rigorozitet të Ligjit për komunikacionin deri në ndalesën e vozitjes

për shkelje të rënda të përsëritura. Po ashtu, ky institut ka rekomanduar që në nëpërmjet programeve të ndryshme edukativo-informative të vetëdijesohen qytetarët, posaçërisht vozitësit, për rolin e tyre në parandalimin e aksidenteve të cilat ndodhin si pasojë e gabimeve të tyre si dhe aftësimi për ta ofruar ndihmën e parë, të angazhohen masmediat

në kampanja të ndryshme që kanë për qëllim parandalimin e aksidenteve, të bëhet largimi i menjëhershëm i automjeteve të vjetra nga qarkullimi, kontrolli teknik i automjeteve dhe autoshkollave të jetë më rigoroz, të bëhen kontrole mjekësore për vozitësit, të respektohen shenjat e komunikacionit nga vozitësit dhe qytetarët etj.

Kryqi i Kuq i Kosovës dhuron një autoambulancë për Klinikën Emergjente

PRISHTINË, 24 TETOR (ER) - Në kuadër të bashkëpunimit ndërmjet Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës dhe Kryqit të Kuq të Kosovës, të mërkurën Kryqi i Kuq i Kosovës ka dhuruar një autoambulancë për nevojat e Klinikës Emergjente në QKUK, me vlerë mbi 10 mijë euro.

Në ceremoninë e dorëzimit-pranimin të kësaj autoambulance morën pjesë drejtori i përgjithshëm i ShSKUK-së, dr. Basri Sejdiu, dr. Rustem Musa, zëvendësministër i Ministrisë së Shëndetësisë, Feride Hyseni, kryetare e Kryqit Kuq të Kosovës dhe dr. Basri Lenjani, drejtor i Klinikës Emergjente në QKUK.

Dr. Rustem Musa, zëvendësministër i Ministrisë së Shëndetësisë, ka falënderuar Kryqin e Kuq të Kosovës për bashkëpunimin dhe ndihmesat e vazhdueshme që po japin për shëndetësinë e Kosovës. Sipas tij, kjo ndihmesë vjen në kuadër të ngritjes dhe

avancimit të shërbimeve shëndetësore që janë duke u bërë në shëndetësinë e Kosovës. Ai ka thënë se ky bashkëpunim ndërmjet Ministrisë dhe Kryqit të Kuq të Kosovës do të vazhdojë edhe në të ardhmen, duke i kontribuar ngritjes së cilësisë së shërbimeve shëndetësore. Ndërsa dr. Basri Sejdiu, drejtor i Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës, pasi ka falënderuar donatorin për dhurim të autoambulancës, ka thënë se pas investimeve në shërbimin emergjent nga Ministria e Shëndetësisë dhe ShSKUK, janë krijuar kushte shumë më të mira për pacientë dhe për stafin shëndetësor që ofron shërbime mjekësore.

Drejtori Sejdiu ka rikujtuar edhe memorandumimin e nënshkruar ndërmjet Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës dhe Kryqit të Kuq të Kosovës, ku ekipet vullnetare të Ndihmës së Parë nga Kryqi i Kuq i Kosovës ofrojnë asistencë teknike për stafin shëndetësor



të Klinikës Emergjente. Feride Hyseni, kryetare e Kryqit të Kuq të Kosovës, ka përmendur disa prej

aktivitetet dhe ndihmesat që ka bërë Kryqi i Kuq i Kosovës për shëndetësinë e Kosovës dhe për QKUK. Hyseni ka ofru-

ar mbështetjen e saj dhe të Kryqit të Kuq të Kosovës për mbështetje të shërbimeve shëndetësore.

Mazreku: Tatimi prej pesëpërqindësh mbi bazën e primeve bruto, në kundërshtim me Ligjin për investimet e huaja

Drejtori ekzekutiv i Shoqatës së Sigurimeve të Kosovës (SHSK), Sami Mazreku, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se që nga viti 1999 e deri më tani kompanitë e sigurimit janë duke u tatuar me norma tatimore të ndryshme mbi primet bruto të grumbulluara gjatë periudhës tatimore. Sipas tij, tatimi prej pesëpërqindësh mbi bazën e primeve bruto për kompanitë e sigurimeve është në kundërshtim me Ligjin për investimet e huaja

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 24 TETOR - Në seancën e kaluar në rend të ditës ishte votimi në parim i Projektligjit për tatimin në të ardhurat e korporatave. Një gjë e tillë nuk ndodhi për shkak të mungesës së kuorumit, pasi në sallën e seancës plenare kishin mbetur vetëm 20 deputetë. Kurse sot (e enjte) do të mbahet vazhdimi i seancës ku sërish në rend të ditës është Projektligji për tatimin në të ardhurat e korporatave.

Drejtori ekzekutiv i Shoqatës së Sigurimeve të Kosovës (SHSK), Sami Mazreku, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se që nga viti 1999 e deri më tani kompanitë e sigurimit janë duke u tatuar me norma tatimore të ndryshme mbi primet bruto të grumbulluara gjatë periudhës tatimore. Sipas tij, ky tatim ka qenë diskriminues për sektorin e sigurimeve dhe në kundërshtim me logjikën e të investuarit në Kosovë, pasi që shumica e kompanive të sigurimeve janë aksionarë të huaj. "Që nga viti 1999 e deri më tani kompanitë e sigurimit janë duke u tatuar me norma tatimore të ndryshme mbi primet bruto të grumbulluara gjatë periudhës tatimore. Deri në vitin 2009 shkalla e tatimit në primet bruto të grumbulluara për kompanitë e sigurimit ka qenë në nivel prej shtatëpërqindësh, e cila në vazhdimësi ka qenë një trajtim jo i barabartë në krahasim me korporatat e tjera të themeluara. Pas vitit 2009 niveli i tatimit është rivlerësuar nga Qeveria e saj kohe dhe

është vendosur të jetë në shkallën prej pesëpërqindësh. Gjithsesi, mënyra e tatimit të kompanive të sigurimit ka mbetur e njëjtë, ajo mbi bazën e primeve bruto të grumbulluara nga kompanitë e sigurimit. Sa iu përket vlerësimeve aktuale, rekomandimi yni është që industria e sigurimeve, respektivisht kompanitë e sigurimeve, të trajtohen në mënyrë të barabartë sikur korporatat e tjera, duke u tatuar për të ardhurat e tyre reale. Një trajtim i barabartë i kompanive të sigurimit me korporatat e tjera të themeluara sipas ligjit, pritet të ndodhë me miratimin e ligjit të ri për tatimin në të ardhurat e korporatave, e që është e mirëseardhur për industrinë e sigurimeve", ka thënë Mazreku, duke shtuar se në draftet e deritanishme të trajtuara nga komisionet parlamentare dhe të paraqitura për diskutime publike, vërehet se nga Qeveria aktuale janë marrë me seriozitet të lartë dhe se përfundimisht, kompanitë e sig-

urimeve do ta kenë mundësinë e trajtimit të barabartë me korporatat e tjera, atë të tatimit në të ardhura reale dhe jo në tatimin në bazë të primeve bruto të grumbulluara. Në pyetjen nëse në saje të këtij pesëpërqindëshi kompanitë e sigurimeve kanë hasur në kritika të shumta sa i përket vonësës së kompensimeve të dëmeve, Mazreku ka thënë se mënyra e të tatuarit prej pesëpërqindësh mbi bazën e primeve bruto, pos që ka qenë në kundërshtim për Ligjin për investimet e huaja, kjo tarifë në masë të madhe ka dëmtuar edhe afarizmin e industrisë

së sigurimeve në vendin tonë. "Tatimi i veçantë që është aplikuar vetëm për kompanitë e sigurimeve në Kosovë në fillim 7 për qind të vlerës së përgjithshme të qarkullimit dhe më pas 5 për qind të qarkullimit, por jo edhe për korporatat e tjera, përpos që ka qenë në kundërshtim për Ligjin për investimet e huaja, kur dihet se gjysma e pronësisë së industrisë së sigurimeve është kapital i huaj, ajo tarifë në masë të madhe ka dëmtuar edhe afarizmin e industrisë së sigurimeve në vendin tonë. Pra, për gati dy dekada industria e sigurimeve u obligua të paguajë një taksë të veçantë që nuk e pagoi asnjë korporatë tjetër që operon në shtetin

tonë. Ndërkaq sa i përket kompensimit të dëmeve, ashtu siç kam thënë edhe më parë, kjo çështje është e rregulluar shumë saktë, me një kontratë të veçantë mes kompanive të sigurimit si dhe qytetarëve të cilët blejnë policat e sigurimit. Andaj kompensimi i dëmeve bëhet në përputhje të marrëveshjes dhe në afatet e paraparë ligjore. Vetë fakti se janë të lidhura mbi një milion kontrata mes kompanive dhe qytetarëve, derisa numri i ankesave në Bankën Qendrore të Kosovës për vitin 2017 ka qenë rreth 200, kjo është një pasqyrë e qartë se kompensimi i dëmeve bëhet në afate kohore të parapara me ligj", ka deklaruar Mazreku.



Asgjësohen 17 mijë lodra që rrezikojnë shëndetin e fëmijëve

Inspektorati i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë deri më tash ka konfiskuar 17 mijë njësi të lodrave të rrezikshme dhe në bashkëpunim me Doganën e Kosovës ka ndaluar 17 importe në kufi

EPOKA
ERE

A. MAVRAJ

PRISHTINË, 24 TETOR - Inspektorati i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë të mërkurën në Kishnicë të Graçanicës ka asgjësuar lodra të ndryshme të konfiskuara. Ministri i Tregtisë dhe Industrisë (MTI), Endrit Shala, në rastin e asgjësimit ka deklaruar se deri më tani janë asgjësuar 17 mijë lodra dhe janë ndaluar mbi 17 të importe llojit të tillë në Doganën e Kosovës. Shala ka thënë se fëmijët më nuk do t'u ekspozohen lodrave të rrezikshme, sepse të gjitha importet që nuk kanë certifikata të cilësisë sipas standardeve të BE-së nuk do të lejohen të hyjnë në tregun e Kosovës. "Sot kam ardhur për ta përcjell nga afër fazën e fundit, asgjësimin e lodrave, dhe ta dërgojmë mesazhin te qyte-

tarët e Kosovës që ne kemi filluar kontrollin e tregut dhe fëmijët tanë nuk do t'u ekspozohen më lodrave të rrezikshme. Ne jemi të përkushtuar që të kemi një kontroll të detajuar të cilësisë së produkteve në tregun e Kosovës. Dua t'ju njoftoj se deri tash kemi konfiskuar 17 mijë njësi të lodrave të rrezikshme dhe në bashkëpunim me Doganën e Kosovës kemi ndaluar 17 importe në kufi. Gjithashtu, sot jam informuar nga inspektorati se është ndaluar edhe një sasi tjetër e cila ka tentuar të zhdoganohet dhe të futet në tregun e Kosovës", ka theksuar ministri Shala. Sipas tij, fokusi do të jetë mbrojtja e konsumatorit në raport me cilësinë e mallrave. "Fokusi im do të jetë mbrojtja e konsumatorit në raport me cilësinë e produkteve dhe, përveç rritjes së inspektimeve në tregun e brendshëm, në



bashkëpunim me doganën po parandalojmë futjen në treg të çfarëdo malli që mund të jetë i rrezikshëm për përdorim nga konsumatori", ka thënë ministri Shala. Ai ka kërkuar nga të

gjithë tregtarët të mos importojnë në Kosovë mallra që nuk i plotësojnë standardet pasi mund ta rrezikojnë shëndetin e fëmijëve. "I thërras të gjithë tregtarët që të kenë kujdes në

produktet që i importojnë dhe i shesin në tregun e Kosovës, të jenë të certifikuar dhe sipas standardeve të BE-së që të mos e rrezikojnë shëndetin e fëmijëve", ka thënë ministri Shala.

Deficiti tregtar i Kosovës në shtator, mbi 257.3 milionë euro

PRISHTINË, 24 TETOR (ER) - Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka publikuar të dhënat lidhur me rrjedhat e eksportit dhe importit për muajin shtator 2018. Të dhënat nga tregtia e jashtme në Kosovë tregojnë për një deficit tregtar më të lartë për 20.2 për qind në muajin shtator 2018, në raport me periudhën e njëjtë të vitit 2017, gjegjësisht në vlerë prej 257.3 milionë eurosh krahasuar me deficitin prej 213.9 milionë eurosh në vitin 2017.

Eksporti mbulon importin me 12.5 për qind.

Eksporti i mallrave në muajin shtator 2018 kishte vlerën 36.6 milionë euro, ndërsa importi 293.9 milionë euro, që është një rritje prej 7.6 përqindësh për eksport dhe një rritje prej 18.5 përqindësh për import, duke krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2017. Sipas të dhënave të grupeve kryesore të eksportit: 42.6 për qind të eksporteve e përbëjnë metalet bazë dhe artikujt prej tyre; 11.3 për qind e përbëjnë plastika, goma dhe artikujt prej tyre; 9.5 për qind e përbëjnë ushqimet e përgatitura, pijet dhe duhani; 9.4 për qind e përbëjnë produktet minerale; 9 për qind e përbëjnë produktet

bimore; 2.8 për qind e përbëjnë artikujt e ndryshëm të prodhuar; 2.4 për qind e përbëjnë tekstili dhe artikujt prej tij.

Ndërsa, sipas të dhënave të grupeve kryesore për import: 16 për qind e përbëjnë produktet minerale; 13 për qind e përbëjnë metalet bazë dhe artikujt prej tyre; 11.1 për qind e përbëjnë ushqimet e përgatitura, pijet dhe duhani; 10.9 për qind e përbëjnë makineritë, pajisjet mekanike dhe elektrike; 7.8 për qind e përbëjnë mjetet e transportit; 7.1 për qind e përbëjnë produktet e industrisë kimike; 6.3 për qind e përbëjnë plastika, goma dhe artikujt prej tyre; 5.6 për qind e përbëjnë tekstili dhe artikujt prej tij etj.

Eksportet e Kosovës në vendet e BE-së arritën në 10.2 milionë euro, ose rreth 28 për qind e eksporteve të përgjithshme, me një rritje prej 14.1 përqindësh. Partnerët kryesorë për eksportin e mallrave në BE janë: Gjermania (7.6 për qind), Holanda (3.4 për qind), Sllovenia (2.2 për qind), Danimarka (2.1 për qind).

Kurse importet e Kosovës nga vendet e BE-së ishin rreth 124.0 milionë euro ose 42.2 për qind e importeve të përgjithshme, me



një rritje prej 19.6 përqindësh. Importet me pjesëmarrje më të lartë ishin nga: Gjermania (10.1 për qind), Italia (5.9 për qind), Spanja (3.7 për qind), Greqia (3.4 për qind), Sllovenia (2.9) etj. Në muajin shtator 2018 eksportet e Kosovës me vendet e CEFTA-s arritën në 15 milionë euro ose 41.1 për qind të eksporteve të përgjithshme, me një rënie prej (-9.8 përqindësh). Partnerë kryesorë për eksport nga vendet e CEFTA-s ishin:

Shqipëria (17 për qind), Maqedonia (11.2 për qind), Serbia (6.9 për qind), Mali i Zi (3.6 për qind).

Ndërsa importet nga vendet e CEFTA-s në muajin shtator 2018 arritën në 82.2 milionë euro ose 28 për qind të importeve të përgjithshme, me një rritje prej 10.2 përqindësh. Vendet me pjesëmarrje më të lartë për import ishin: Serbia (12.8 për qind), Shqipëria (6.7 për qind), Maqedonia (5.4 për qind) dhe B&H (2.6 për qind).

Eksportet e Kosovës me vendet e tjera të botës arritën në 11.3 milionë euro ose 30.9 për qind. Si partnerë më të rëndësishëm nga këto vende për eksport, vlen të përmenden: India (21.2 për qind) dhe Zvicra (5.8 për qind).

Ndërsa importet e Kosovës me vendet e tjera të botës arritën në 87.6 milionë euro ose 29.8 për qind. Vendet me pjesëmarrje më të lartë për import në këtë grup ishin: Turqia (9.5 për qind) dhe Kina (9.5 për qind).

Miratohet buxheti i Komunës së Malishevës për vitin 2019

MALISHEVË, 24 TETOR (ER) - Kuvendi Komunal i Komunës së Malishevës ka mbajtur mbledhjen e tretë urgjente, në të cilën është miratuar projektbuxheti për vitin 2019. Projektbuxheti është miratuar unanimitisht nga të gjithë anëtarët e Kuvendit të kësaj komune që ishin 30 në mbledhje. Po ky Kuvend Komunal unanimitisht ka

shfuqizuar dy vendimet e datës 28 shtator 2018, ku ishte miratuar projektbuxheti, vendime të cilat, sipas MAPL-së, ishin në kundërshtim me ligjin. Në projektbuxhetin e propozuar nga kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, kanë hyrë edhe propozimet e tjera të anëtarëve të Kuvendit Komunal të Malishevës.



Vlerësohet bashkëpunimi në mes të Komunës së Skenderajt dhe KFOR-it

SKENDERAJ, 24 TETOR - Nënkryetari i Komunës së Skenderajt, Nuredin Lushtaku, ka pritur të mërkurën në takim përfaqësuesit e Ekipit Ndërlidhës të Monitorimit (LMT) në kuadër KFOR-it, me të cilët ka diskutuar për bashkëpunimin e deritashëm në mes të Komunës së Skenderajt dhe KFOR-it.

Palët kanë vlerësuar bashkëpunimin e deritanishëm si dhe kanë shprehur përkushtimin e tyre për të vazhduar edhe më tutje thellimin e këtij bashkëpunimi. Me këtë rast nënkryetari Lushtaku ka përshëndetur në emër të kryetarit Bekim Jashari, kapitenen Spela Vese, koman-

dante e ekipit LMT nga KFOR-i, e cila sot ka përfunduar misionin e shërbimit në Kosovë, derisa në vend të saj ka ardhur kapiteni Dejan Gantar, i cili si komandant do ta udhëheqë Ekipin Ndërlidhës të Monitorimit të KFOR-it në Skenderaj. Në fund të këtij takimi janë shkëmbyer disa dhurata për të dyja palët.

'EC Ma Ndryshe' e quan të gabuar shenjzimin e rrugëve për orientimin e vizitorëve në Prizren

PRIZREN, 24 TETOR (ER) - Komuna e Prizrenit në fillim të kësaj jave në uebfaqen e vet zyrtare ka njoftuar se me qëllim të promovimit të trashëgimisë kulturore dhe orientimit më të lehtë të vizitorëve të huaj janë vendosur tabelat informuese që tregojnë drejtimin dhe largësinë e monumenteve kulturore apo institucioneve me rëndësi. Projekti në fjalë është realizuar nga Drejtoria e Turizmit dhe Zhvillimit Rural, ndërsa tabelat janë vendosur në udhëkryqet kryesore të qytetit. Organizata "EC Ma Ndryshe" ka konsideruar se ky hap, edhe pse shumë i vonshëm për Komunën e Prizrenit, është një investim i duhur dhe i mirëseardhur. Megjithatë, kjo organizatë ka vërejtur se ky projekt ka një sërë gabimesh që duhet të adresohen. "Komunat e ndryshme të Kosovës në vitet e fundit në raste të ndryshme kanë vendosur shenja për nevojat e tyre të promovimit dhe orientimit të vizitorëve. Fatkeqësisht, çështja e rregullimit të shenjzimit të lokaliteteve të trashëgimisë kulturore nuk ka qenë e rregulluar deri vonë nga niveli qendror. Më 20 shtator të këtij viti është përmbyllur procesi i konsultimit publik për Draft -Udhëzimin Administrativ Nr. XX/2018 për specifikat e Shenjimit të Trashëgimisë Kulturore dhe Vendeve Turistike të udhëhequr nga MKRS-ja. Për këtë arsye EC



konsideron se ky hap i Komunës së Prizrenit ka qenë i ngutshëm dhe paraqet shpenzim të paarsyeshëm të parasë publike për një investim, i cili së shpejti duhet të zëvendësohet në mënyrë që t'u përshtatet standardeve të kërkuara", është thënë në komunikatën e "EC Ma Ndryshe". Sipas kësaj organizate, shenjat e vendosura kanë edhe gabime përmbajtjesore dhe teknike. "Shumica e shenjave kanë gabime të mëdha drejtshkri-

more, pastaj në raste të caktuara ka pasaktësi, derisa nganjëherë përkthimet joadekuate në gjuhët përkatëse paraqesin defekte serioze. Po ashtu ka edhe gabime në kalkulim të distancave nga lokacioni i vendosur deri te destinacioni. 'EC Ma Ndryshe' rekomandon që Komuna e Prizrenit, gjegjësisht Drejtoria e Turizmit dhe Zhvillimit Rural, t'i marrë parasysh çështjet e ngritura dhe t'i adresojë në mënyrë prioritare", është thënë në këtë komunikatë.

Mbrojtja e kullës së Sulejman Vokshit në Gjakovë, në rrezik

GJAKOVË, 24 TETOR (ER) - "Në mbledhjen e radhës së Asamblesë Komonale në Gjakovë, si pjesë e rendit të ditës, nga kryetari i Komunës së Gjakovës, Ardian Gjini, është sjell pika për shfuqizimin e vendimit për interesin e veçantë për objektin e mbrojtur të trashëgimisë kulturore, kulla e Sulejman Vokshit", është thënë në njoftimin për media të Alternativës në Gjakovë, parti kjo e cila drejtohet nga Mimoza Kusari-Lila. Sipas Alternativës, asambleja e kaluar me kërkesën e ish-kryetares Kusari-Lila kishte marrë vendim që ky objekt të jetë i interesit të veçantë, në mënyrë që të kompensohen banorët e kësaj kulle dhe objekti si pjesë e trashëgimisë kulturore ta ketë trajtimin dhe mbrojtjen institucionale të Komunës së Gjakovës që të parandalohet

shitja e paralajmëruar nga banorët e saj. "Me këtë rast gjatë mandatit të qeverisjes Kusari-Lila ishin përfunduar edhe procedurat e shpronësimit si dhe ishte ndarë buxheti për kompensimin e banorëve në bazë të vlerësimit nga Ministria e Financave dhe Këshilli për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore. Që nga ditët e para të qeverisjes kryetari aktual i Gjakovës, Ardian Gjini, kishte në shënjestër këtë objekt, duke dezinformuar dhe kontestuar buxhetin që e kishte trashëguar për shpronësimin e Kullës", është thënë në njoftimin për media. Alternativa në Gjakovë i ka bërë thirrje Këshillit për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore që t'i parandalojë sa më parë veprimet e kryetarit Gjini, duke ia shpjeguar atij rëndësinë historike dhe kulturore që paraqet kjo kullë për trashëgiminë.



(Procesi Gjyqësor i Prizrenit më 1946 sipas dokumenteve të gjykatave ish-jugosllave. Para trupit gjykues dolën 34 patriotë të cilëve gjyqi ua shqiptoi dënimet: gjashtë veta i dënoi me pushkatim, të tjerët me vite të shumta burg) (4)

Arrestimi i anëtarëve të organizatës ilegale nacional demokratike shqiptare



Prof. dr. Sabile KEÇMEZI-BASHA

Menjëherë pas çlirimit të vendit hetuesit e UDB-së filluan t'i përcillnin intelektualët në veçanti dhe popullin shqiptar në përgjithësi. E dinin pushtetarët se shqiptarët nuk ishin të kënaqur me gjendjen që kishte pllakosur në Kosovë. Ata e dinin që dëshirën e tyre dhe qëllimet që i bënin. E dinin edhe se ata (shqiptarët) kurrë nuk do të pajtohen me robërinë e imponuar dhe me gjendjen e okupuar. Më 1945 organet e ndjekjes hetuan dhe zbuluan një numër të madh të organizatës ilegale patriotike prej 34 vetash dhe që të gjithë i arrestuan për një afat të shkurtër kohor. Të arrestuarit ishin:

1. Halim Spahija
2. Tahir Deda
3. Fehim Ibrahim
4. Hasan Rustemi
5. Abdyl Rexhepi
6. Maliq Balija (hoxhë Maliqi)
7. Basri Sallku (Boshnjaku)
8. Qamil Jemini
9. Sadik Mehmeti-Peqani
10. Ibrahim Abdyl
11. Muhamet Veseli
12. Xhemil Fluku-Kumona
13. Sefedin Ahmeti-Plumi
14. Abdullah Hajrullahu
15. Abdullah Hamza-Palajo
16. Sinan Hazëri
17. Rifat Krasniqi-Sokrat, Skenderbeg
18. Kajtaz Ramadani (Leka)
19. Ahmet Dërguti-Haj
20. Kadri Minushi-Vrug
21. Sheh Muhedini-Jemeni
22. Vaid Mustafa
23. Laura Shmani
24. Nesibe Zhuri
25. Gjulina Mateja
26. Mane Shyti
27. Luqija Bashota
28. Çeçile Krasniqi
29. Roza Mjeda
30. Mrika Gjoka
31. Roza Cuku
32. Rexhep Abdullahu Kabashi "Tomorri"
33. Kadri Ramadani "Topalli"
34. Ruzhdi Kabashi

GJYQIT KRAHINUER TË KOSOVËS E METOHISË PRIZREN

PRETENCË Në bazë të vendimit të AVNOJ-it,

datë 3 Fruer 1945, mbi formimin dhe kompetencën e Prokurorit Publik të Jugosllavisë Federative, Prokurori Publik i Kosovës dhe i Metohisë:

AKUZON

Halim Spahin, lindur më 1897 në Gjakovë, banues në Kukës (Shqipni), me profesion tregtar, nënshtetas Shqiptar, tani ndodhet nën vërejtje në burgun e këtushëm.

Tahir Deda, "Unë", lindur në Gjakovë më 1910, banues në Prizren, nëpunës i Këshillit Krahinuer për Kosmet, nënshtetësia shqiptare tani ndodhet nën vërejtje në burgun e këtushëm.

Tahir Deda, "Unë", lindur në Gjakovë më 1910, banues në Prizren, nëpunës i Këshillit Krahinuer për Kosmet, nënshtetësia shqiptare tani ndodhet nën vërejtje në burgun e këtushëm.

Fehim Ibrahim, nënshtetas Jugosllavë, vjeç 45, i lindur e banues në Prizren, me profesion tregtar, tani ndodhet nën vërejtje në burgun e këtushëm.

Hasan Rustemi, i lindur në Selim, më 1911 në Gjakovë, banues në Prizren, nëpunës i Këshillit Populluar të Rrethit Prizren, nënshtetas Shqiptar, tani ndodhet nën vërejtje në burgun e këtushëm.

Abdyl Rexhepi, i lindur më 1906, në Verlen, Qarku i Korçës (Shqipni), nëpunës i Financës në Prizren, nënshtetas Shqiptar, tani ndodhet nën vërejtje në burgun e këtushëm.

Maliq Balija (Hoxh Balija), vjeç 36, lindur në Javur Rreth i Rahovecit, banues në Prizren, me profesion Hoxhë, nënshtetas Jugosllavë, tani nën vërejtje në burgun e këtushëm.

Basri Sarkoviqi Boshnjaku, i lindur me 1907-n në Ferizaj, e banues në Ferizaj, me profesion punëtor, nënshtetas Jugosllav, tash nën vërejtje në burgun e këtushëm.

Qamil Jemini, vjeç 52, lindur e banues në Katundin Mushtishtë, rrethi Suharekës, me profesion bujk, nënshtetas Jugosllavë, tani ndodhet nën vërejtje në burgun e këtushëm.

Sadik Mehmeti Peçani, vjeç 52, lindur e banues në Kartundin Peçan, rrethi Suharekës, me profesion bujk, nënshtetas Jugosllav, tash ndodhet nën vërejtje në burgun e këtushëm.

Ibrahim Abdyl, vjeç 46, lindur e banues në Katundin Budakovë, Rrethi Suharekës, bujk, nënshtetas Jugosllav, tani ndodhet nën vërejtje në burgun e këtushëm.

Muhamet Vejseli, vjeç 36, lindur e banues në katundin Reçan, rrethi Suharekës, bujk, nënshtetas jugosllav, tash ndodhet nën vërejtje në burgun e këtushëm.

Xhemil Fluku "Kumona" vjeç 33, lindur e banues në Prizren, me profesion zdrukthëtar, nënshtetas Jugosllav, tani ndodhet nën vërejtje në burgun e këtushëm.

Abdulla Hajrullahu, vjeç 38, lindur e banues në Prizren, furrar, nënshtetësia Jugosllave, tash ndodhet nën vërejtje në burgun e këtushëm.

Abdulla Hamza "Paljaço", lindur e banues në Prizren, kafexhi, nënshtetas Jugosllav, tash ndodhet nën vërejtje në burgun e këtushëm.

Sinan Hëzër, lindur me 1914-n, e banues në Prizren, zdrukthëtar, nënshtetas Jugosllav, tash ndodhet nën vërejtje në burgun e këtushëm.

Rifat Krasniqi "Sokrat Skënderbeg", lindur me 1917-n, në Katundin Mamushë, rrethi i Rahovecit ku banon. Me profesion Gjyqtar, nënshtetas Jugosllav, tash ndodhet nën vërejtje në burgun e këtushëm.

Kajtaz Ramadani "Leka", vjeç 55, lindur dhe banues në katundin Kijevë rrethi i Rahovecit bujk, nënshtetas Jugosllav, tash ndodhet nën vërejtje në burgun e këtushëm.

Ahmet Dërguti "Haj", lindur me 1911-n në Rahovec, ku atje vanon, tregtar (ndihmës), nënshtetas Jugosllav, tash ndodhet nën vërejtje në burgun e këtushëm.

Kadri Minushi "Vrug", vjeç 42, lindur e banues në katundin Damanik, rrethi i Rahovecit, bujk, nënshtetas Jugosllav tash ndodhet nën vërejtje burgun e këtushëm.

Sheh Muhedini "Jemen", vjeç., 25, lindur e banues në Rahovec, Sheh (Dervish), nënshtetas jugosllav, tash ndodhet nën vërejtje në burgun e këtushëm.

Vahit Mustafa, i lindur me 1920-n, në katundin Mamushë, rrethi i Rahovecit, nënshtetas jugosllav, tash gjendet nën vërejtje në burgun e këtushëm.

Laura Shmani, vjeç 25, e lindur në Parma, Provinça Emilja (Itali),

banuese në Prizren, shtëpiake, kombësia italiane, tash ndodhet nën vërejtje në burgun e këtushëm.

Nasibe Zhuri, vjeç 17, e lindur e banuese në Prizren, nxënëse e Gjinnazit, nënshtetase jugosllave, tash ndodhet nën vërejtje në burgun e këtushëm.

Gjulina Mateja, vjeç 18, e lindur e banuese në Prizren, rrobaqepëse, nënshtetase jugosllave, tash ndodhet nën vërejtje në burgun e këtushëm.

Mane Shyti, vjeç 19, e lindur në Novosell rrethi i Gjakovës, banuese në Prizren, shtëpiake, nënshtetësia jugosllave, tash ndodhet në vërejtje në burgun e këtushëm.

Luçije Bashota, vjeç 17, e lindur e banuese në Prizren, nxënëse gjinnazi, nënshtetase jugosllave, tash ndodhet nën vërejtje në burgun e këtushëm.

Çeçile Krasniqi, vjeç 23, e lindur e banuese në Prizren, nënshtetase jugosllave, tash ndodhet nën vërejtje në burgun e këtushëm.

Roza Mjeda, vjeç 18, e lindur e banuese në Prizren, rrobaqepëse, nënshtetase jugosllave, tash ndodhet nën vërejtje në burgun e këtushëm.

Mrika Gjoka, vjeç 19, e lindur e banuese në shtëpiake, nënshtetase jugosllave, tash ndodhet nën vërejtje në burgun e këtushëm.



Roza Cuki, e lindur e banuese në Prizren, vjeç 19, shtëpiake, nënshtetase jugosllave, tash ndodhet nën vërejtje në burgun e këtushëm.

Rexhep Abdullahu Kabashi "Tomorri", vjeç 23, lindur në Kabash, banues në Korishë, rrethi i Prizrenit, bujk, sekretar i KNÇ Lubizhdë, nënshtetas jugosllav tash ndodhet nën vërejtje në burgun e këtushëm.

Kadri Ramadani "Topall", vjeç 23, lindur e banues në Prizren, briskaxhi, shqiptar, nënshtetas jugosllav, tash ndodhet nën vërejtje në burgun e këtushëm.

Ruzhdi Kabashi, vjeç 18, lindur e banues në Prizren, mësues, nënshtetas jugosllav, tash ndodhet nën vërejtje në burgun e këtushëm.

Dhe i akuzojmë për këto veprimtari: Përgjatë muajve maj e qershor të vitit 1945, si armiq të regjimit të sotshëm të Jugosllavisë D. Federative, të ndërgjegjshëm dhe me paramejtim kanë marrë pjesë në organizatën ilegale të ashtuquajtur "Komiteti Nacional Demokratik" dhe janë bamun anëtarë e drejtues të Komitetit Qendror për Kosovë e Metohi, me qendër në Prizren, i cili komitet ka pasur për qëllim udhëheqjen supreme politike dhe ushtarake në të gjithë Kosmetin. (Vijon)



U hiqet imuniteti dy deputetëve francezë



Strasburg, 24 tetor - Parlamenti Evropian votoi të mërkurën heqjen e imunitetit parlamentar të dy eurodeputetëve francezë të Lëvizjes Kombëtare (RN, ish-FN), Steeve Briois, zëvendëskryetar i lëvizjes dhe Sophie Montel, objekt të një hetimi për "provokim për

diskriminim".

Gjatë një votimi të hapur deputetët evropianë miratuan me shumicë të theksuar heqjen e imuniteteve. Emrat e dy eurodeputetëve përmendën në një hetim të kryer nga një magjistrat i Nanterres, pranë Parisit, pas një ankese ndaj X depozituar në maj 2014 nga

shoqata "Maison des Potes" (Shtëpia e Miqve) rrjet i shoqatave të specializuara në luftën kundër diskriminimeve. Në nëntor 2016 Parlamenti Evropian hoqi për të njëjtën çështje imunitetin parlamentar të eurodeputetit Jean-François Jalkh, një person i afërt me Marine Le Pen, kryetarja e

Paketa të dyshimta dërguar Clintonit, Obamas dhe CNN-it

Në magazinën e postës së rrjetit CNN u gjet një paketë e dyshimtë që ishte dërguar në adresë të CNN-it, por ende nuk është konfirmuar nëse paketa ishte e ngjashme me pako të tjera që janë dërguar në adresë të Shtëpisë së Bardhë si dhe në banesat e ish-presidentit Obama dhe çiftit Bill dhe Hillary Clinton

WASHINGTON, 24 TETOR - Ndërtesa "Time Warner" në Nju Jork është evakuuar pasi në magazinën e postës së rrjetit CNN u gjet një paketë e dyshimtë që ishte dërguar në adresë të CNN-it. Ende nuk është konfirmuar nëse paketa ishte e ngjashme me pako të tjera që janë dërguar në adresë të Shtëpisë së Bardhë, si dhe në banesat e ish-presidentit Obama dhe çiftit Bill dhe Hillary Clinton. Policia e Nju Jorkut tha se mori njoftim për paketën që i ishte dërguar CNN-it në orën 9:53 të mëngjesit të mërkurën. Një tjetër paketë e dyshimtë është interceptuar nga forcat e rendit në Nju Jork, ku policia ka evakuuar zyrat e redaksisë të rrjetit televiziv CNN. Paketa ishte e ngjashme me ato që janë dërguar në adresë të ish-presidentit Obama si dhe çiftit Bill dhe Hillary

Clinton.

Të mërkurën Shtëpia e Bardhë dënoi tentativat për goditje me lëndë plasëse kundër ish-presidentit Barack Obama si dhe ish-presidentit Bill Clinton dhe Hillary Clinton.

Zëdhënësja e Shtëpisë së Bardhë, Sarah Huckabee Sanders, tha përmes një deklaratë të mërkurën, se "këto akte terrorizuese janë të pështira dhe çdokush që është përgjegjës do të japë llogari deri në maksimumin e ligjit. Shërbimi sekret dhe agjenci të tjera të rendit po hetojnë dhe do t'i ndërmarrin të gjitha hapat e nevojshëm për ta mbrojtur këdo që kërcënohet nga këta individë frikacakë".

Shërbimi Sekret i Shteteve të Bashkuara tha të mërkurën se ka interceptuar paketa të dyshimta, të identifikuar si pajisje të



mundshme shpërthyesë, dërguar në shtëpitë e ish-presidentit Barack Obama dhe ish-sekretares së Shtetit, Hillary Clinton. Shërbimi sekret tha se kishte kapur një paketë që i ishte dërguar Clintonit në Westchester, një zonë në veri të Manhatanit të martën.

Gazeta "New York Times" njofton

se pajisja e gjetur pranë shtëpisë së ish-presidentit Bill Clinton dhe kandidates demokrate për presidente në vitin 2016 është e ngjashme me atë që ishte vendosur në një kuti postare para shtëpisë së filantropit, George Soros të hënën.

Një paketë tjetër u dërgua në banesën e Obamas në

Uashington të mërkurën. "Paketat u identifikuan menjëherë gjatë procedurës rutinë të kontrollit si pajisje që mund të jenë shpërthyesë dhe u trajtuan si të tilla", tha Shërbimi Sekret në një deklaratë. Në deklaratë shtohet se as Clintoni e as Obama nuk i morën paketat dhe nuk ishin në rrezik t'i merrnin.

Stoltenbergu: Rusia në shkelje të traktatit bërthamor

BRUKSEL, 24 TETOR - Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, tha se Rusia ishte "në shkelje" të një traktati të rëndësishëm bërthamor dhe i kërkoi Moskës që të vepronte në përputhje me marrëveshjen në një mënyrë transparente dhe të verifikueshme. Komentet e Stoltenbergut pasojnë njoftimin e presidentit Donald Trump për t'i tërhequr Shtetet e Bashkuara nga Traktati i Forcave Bërthamore me Rreze të Shkurtër dhe të Mesme Veprimi (INF) për shkak të shkeljeve të Rusisë. Sekretari i Përgjithshëm i NATO-



s, Jens Stoltenberg, tha se shkelja e traktatit bërthamor nga Rusia nuk mund të lejohet të vazhdojë.

"Të gjithë aleatët janë të pajtim-it që Traktati i Forcave Bërthamore me Rreze të

Shkurtër dhe të Mesme Veprimi (INF) është i rëndësishëm dhe pikërisht për këtë arsye ne jemi kaq të shqetësuar për qëndrimin rus. Gjithashtu, të gjithë aleatët janë të pajtim-it me ShBA-në, se Uashingtoni e ka respektuar plotësisht traktatin. Në të njëjtën kohë, ne jemi deklaruar në mënyrë të qartë se shpjegimi më i besueshëm është se Rusia tani është në shkelje të traktatit dhe për këtë arsye sfida, problemi, është sjellja ruse, që ne e kemi parë gjatë shumë viteve dhe është thënë qartë se kjo nuk mund të vazhdojë. Ne nuk mund të kemi një traktat mes dy

palëve, që respektohet vetëm nga njëra prej tyre", tha ai.

Sekretari i NATO-s i bëri komentet pak ditë pasi Trumpi njoftoi synimin e tij për t'i tërhequr Shtetet e Bashkuara nga Traktati i Forcave Bërthamore me Rreze të Shkurtër dhe të Mesme Veprimi (INF) për shkak të shkeljeve të Rusisë. Traktati, i cili u nënshkrua në dhjetor 1987 nga presidentët e atëhershëm Regan dhe Gorbacov, u kërkoi të dyja palëve t'i eliminojnë të gjitha armët bërthamore me rreze veprimi nga 500 deri në 500 kilometra së bashku me sistemet e lëshimit.

Në Brazil mbahen zgjedhjet presidenciale

BRAZILI, 24 TETOR - Në Brazil kandidati për president i krahut të majtë, Fernando Haddad, parashikon fitore të zgjedhjeve presidenciale të së dielës kundër kandidatit të partisë

Social Liberale, Jair Bolsonaro. Duke folur në një tubim në Rio de Janeiro të martën në mbrëmje, Haddad përmendi të dhënat e një sondazhi të ri që, siç tha, tregon se mbështetja ndaj tij po

rritet, ndërsa po bie epërsia që gëzon rivali i tij. Haddad, i cili kandidon për Partinë e Punëtorëve, kërkoi që ai dhe Jair Bolsonaro, ish-ushtarak në pension dhe anëtar

i kongresit, të debatojnë përpara zgjedhjeve të së dielës. Sipas tij, demokracia e Brazilit do të vuajë nëse votuesit nuk dëgjojnë dhe krahasojnë idetë e kandidatëve.



Tri gra nga Kosova në garë për çmimin Oscar

EPOKA ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 24 TETOR - Sivjet është vit i veçantë për industrinë e filmit të Kosovës, pasi tri regjisore, Lendita Zeqiraj, Blerta Zeqiri dhe More Raça, janë kualifikuar për edicionin e 91-të të Çmimeve të Akademisë - Oscar.

Filmi debutues i metrazhit të gjatë i Blerta Zeqirit "Martesa" fitoi çmimin FIPRESCI dhe çmimin special të jurisë në Festivalin "Tallin Black Nights" në vitin 2017. Në vitin 2012, po e njëjta e fitoi çmimin e jurisë për filmin e shkurtër "Kthimi" në Festivalin e Filmit Sundance.

Alban Ukaj, Adriana Matoshi dhe Genc Salihu luajnë protagonistët në rrëfimin e një burri që e mban një fshehtësi nga gruaja e tij - është i dashuruar në shokun e tij të ngushtë. Në një intervistë për "Hollywood Reporter", duke folur për motivimin e saj për ta shkruar këtë histori, Zeqiri tha: "Nuk ka kuptim të ndalohet dashuria".

"Martesa" është propozimi zyrtar i Kosovës për Oscar, kategorinë e filmit më të mirë në gjuhë të huaj.



Filmi i shkurtër i Lendita Zeqiraj "Gardhi" u kualifikua duke ngadhënjyer si filmi më i mirë i

shkurtër në Festivalin Ndërkombëtar të Filmit në Hamptons dhe si filmi më i mirë

nën 15 minuta në Festivalin e Filmit të Shkurtër në Palm Springs.

Ky film e përcjell një fëmijë të vogël, të cilin e luan Art Lokaj, duke u ballafaquar me veset e familjes së tij të përcudnuar, derisa miku i tij rom e pret jashtë. Filmi prek mbi temën e përgjithësisht, shovinizmit dhe racizmit në shoqërinë e Kosovës.

"Ajo" nga More Raça është përzgjedhur si një ndër finalistët e Manhattan Short Film Festival. Filmi është shfaqur në mbi 350 qytete nëpër gjashtë kontinente dhe ka fituar të drejtën të garojë për Oscar. "Ajo" flet për temën e dhunës në familje dhe e përcjell trimërinë e një vajze të vogël, të luajtur nga Diella Valla, e cila e bën të pamundurën për ta shpëtuar vetveten dhe nënën e saj, të cilën e luan Aurita Agushi. "Këto tri kualifikime vetëm sa vazhdojnë ta pasqyrojnë trendin e zhvillimit të industrisë kosovare të filmit, derisa po prodhojmë gjithnjë e më shumë filma dhe i ndajmë ata me botën. Kemi shpresa të mëdha për atë se çfarë do të sjellë e ardhmja për talentët tanë", ka thënë Arben Zharku, drejtor i Qendrës Kinematografike të Kosovës.

Në Muze u hap faza e parë e projektit 'Prishtina: Qyteti i Nderit dhe Mirënjohjes'



PRISHTINË, 24 TETOR (ER) - Në Muzeun e Kosovës u hap ekspozita "Prishtina: Qytet i Nderit dhe Mirënjohjes", organizuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Muzeu i Kosovës dhe Ambasada e ShBA-së në Kosovë, ku u prezantua vepra artistike që tregon për rrugëtimin e Prishtinës nëpër etapa të ndryshme historike.

Në hapje të ekspozitës mori pjesë edhe ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, i cili e konsideroi këtë vepër si një punë të mrekullueshme, e cila do ta rendisë Prishtinën në mesin e qyteteve botërore që mbajnë vullën e ndërtimit të paqes. "Në cilësinë e ministrit të Kulturës dua t'ju përgëzoj që jeni angazhuar në projekt dhe sot të gjithë ne kemi arsye të ndihemi mirë për faktin se deri në këtë fazë ia kemi dalë t'i realizoni me sukses përkushtimet dhe detyrat tuaja", ka thënë ministri Gashi, duke premtuar se MKRS-ja do të vazhdojë ta mbështesë menaxh-

mentin e Muzeut të Kosovës në mënyrë që vepra monumentale, edhe dokumentet e artit që janë krijuar në fazën e dytë, të promovohen dhe të rrugëtojnë nëpër vendet e tjera si pjesë e përkushtimit për të treguar storien e Prishtinës dhe të Kosovës, përmes këtyre veprave të jashtëzakonshme që janë punuar. "Kemi shumë arsye për ta bërë këtë. Së pari se përkushtimet e shtetit dhe të Qeverisë së Republikës së Kosovës për ndërtimin e vazhdueshëm të paqes, tolerancës dhe mirëkuptimit me përmbytjen e qëllimeve dhe mesazheve të projektit të zhvilluar në të dy fazat, janë tërësisht në harmoni me njëra-tjetrën. Prandaj, kemi arsye të ndihemi mirë që institucionet tona të trashëgimisë kulturore, në këtë rast Muzeu i Kosovës, me ndihmën e programeve mbështetëse të aleatit tonë më të madh, ShBA-së, po arrijnë që jashtëzakonisht mirë t'i transmetojnë këto përkushtime për paqe, mirëkuptim dhe tolerancë", ka

deklaruar ministri Gashi. Ai ka porositur studentët dhe të angazhuarit në projekt së bashku me mentoren e tyre Ellen Frank që të japin më të mirën në veprën e tyre ashtu që ata t'i reflektojnë vlerat e Republikës së Kosovës në mënyrë të shkëlqyeshme. "Veprat e artit ndonjëherë flasin më shumë dhe më fort sesa fjalët e politikës", ka thënë ministri Gashi. Ellen Frank, drejtoreshë artistike e Organizatës "Qytetet e paqes" - eksperte këshilluese nga Programi i Fullbright Specialist, ka thënë se kjo nuk është punë personale, por e të gjithëve dhe ka falënderuar artistët e rinj të veprave të sotme dhe i ka dekoruar ata. "Kjo nuk është për mua, është për ju, dhe është bërë nga ju. Dua t'ju tregoj një histori të shkurtër. Ekzistojnë histori të ndryshme dhe një nga ato që më pëlqen është ajo e dritës së artë. Drita e artë jeni ju. Është detyrë e neve, me qeverinë, ministritë, artistët, profesorët, të kapin këto copëza të dritës dhe t'i bashkojnë", ka thënë Franku.

Çmimi Kombëtar për Veprimtari Jetësore 'Niketë Dardani' iu dha kompozitorit Akil Koci

PRISHTINË, 24 TETOR (ER) - Në një ceremoni të organizuar në kabinetin e ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, u bë ndarja e Çmimit Kombëtar për Veprimtari Jetësore "Niketë Dardani" dhe çmimeve vjetore për vepra muzikore për vitin 2017. Çmimi Kombëtar për Veprimtari Jetësore "Niketë Dardani" iu dha kompozitorit Akil (Mark) Koci dhe në bazë të Rregullores për ndarjen e çmimeve për muzikë merr edhe shpërblimin financiar prej 5 000 eurosh. Po ashtu, çmimi u shoqërua edhe me një

plllakate. Çmimi për veprat vokalo-instrumentale dhe muzikore-skenike iu nda kompozitorit Krist Lekaj për veprën "Requiem". Atij iu ndanë mjetet financiare në vlerë prej 5 000 eurosh. Çmimi për veprat orkestrale-simfonike dhe koncertale iu nda kompozitorit Mendi Mengjiqi për veprën "Simfoni". Fituesit të këtij çmimi iu dhanë 4 000 euro. Çmimi për veprën kamertale iu nda kompozitorit Ardian Halimi për veprën "Quartet" dhe u shpërblye me 2 000 euro.



E rrallë

Parku i fshehtë në Nju Jork ku hyjnë vetëm ata që kanë çelës

Thellë në Manhatan është një park me histori të veçantë, histori që e bën të jetë një nga thesaret e qytetit. Historia e parkut Gramercy nis në vitin 1831, kur një avokat vizionar për hapësirat e mëdha, Samuel B. Ruggles, bleu atë që në atë kohë ishte jo më shumë se një kënetë. Banorët paguajnë rreth 350 dollarë në vit për ta



mbajtur çelësin dhe bravat e parkut ndërrohen çdo vit. Sot janë 39 ndërtesa rrotull parkut, banorët e të cilave kanë të drejtë të marrin një çelës.

BARSOLETA E DITËS



Burri, mysafirëve: Mirë e keni, ashtu është!
Gruaja: Pse bre burrë po ua bënë rrafsh mysafirëve?
Burri: Valla grua, edhe ti hiq keq s'e ke!



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

“ALPHA” 3D,

Aventure/Drame/Familjar; 1 ore 36 min

Rolet: Kodi Smit-McPhee, Jóhannes Haukur Jóhannesson
 Regjia: Albert Hughes

Vetëm gjatë vikendit në ora 14:00



Në ora 16:00

“JOHNNY ENGLISH STRIKES AGAIN”

Aksion/Aventure/Komedi; 1 ore 28 min

Rolet: Rowan Atkinson, Olga Kurylenko, Emma Thompson, Ben Miller, Miranda Hennesy, Jake Lacy, etj.
 Regjia: David Kerr



Në ora 18:00

“NIGHT SCHOOL”

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Kevin Hart, Tiffany Haddish, Rob Riggle, Taran Killam, Romany Malco, etj.
 Regjia: Malcolm D. Lee



Në ora 20:00

“SIBERIA”,

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Keanu Reeves, Ana Ularu, Pasha D. Lynchnikoff, James Gracie, Eugene Lipinski, Rafael Petardi, Veronica Ferres, Molly Ringwald, etj.
 Regjia: Matthew Ross



Në ora 22:00

“VENOM” 3D,

Aksion/Horror/Fantastiko-Shkencor; 1 ore 52 min

Rolet: Tom Hardy, Michelle Williams, Riz Ahmed, Scott Haze, Reid Scott, etj.
 Regjia: Ruben Fleischer
 Based on the Marvel Comics



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.

FOTO E DITES



Një grua e moshuar nga rajoni i Kutchit në perëndim të shtetit Gujarat në Indi shihet duke kërkuar ushqim. /AP/

E jashtëzakonshme

Jeta në ishullin e vogël të Migingos

Ishulli i Migingos ndodhet në liqenin Viktoria në kufirin në mes të Ugandës dhe Kenias. Një shkëmb i rrumbullakët në mes të ujit, i mbuluar me kasolle metalike, ishulli Migingo që ngrihet nga ujërat e liqenit Viktoria, duket si një breshkë hekuri. Zona me një popullsi të dendur mezi mbulon një të katërtën e një hektari.



Banorët e saj janë të vendosur në baraka hekuri, bare, shtëpi publike dhe një porti të vogël.



DASHI


Edhe pse gjatë ditës do të keni mjaft

agjendë të ngarkuar, do ta gjeni kohën dhe mundësinë për t'ju përkushtuar më të rinjve.



DEMI

Sot ndjenja e xhelozisë nuk po ju ndahet. Me kalimin e orëve do të kuptoni që çdo gjë ishte e kotë dhe partneri ka sy vetëm për ju.



BINJAKËT

Do të irritoheni me çdo gjë dhe me çdo situatë. Sidomos për ju që këtë ditë jeni në punë gjërat do të shkojnë shumë keq.



GAFORRJA

Partneri dhe personat e dashur do të jenë pjesë e juaja gjatë gjithë ditës sot. Po mendoni për dhuratat dhe surprizat që do t'ju bëni atyre që kanë ditëlindje.



LUANI

Edhe pse sot nuk ndiheni mirë nga gjendja shëndetësore, do t'ju duhet të mbyllni disa gjëra të rëndësishme që i kishit lënë për çastin e fundit.



VIRGJËRËSHA

Do të keni debatë të ashpra me një ortak në biznes ose me eprorin tuaj. Muaji që po vjen nuk do t'ju gjejë mirë nga ana financiare.



PESHORJA

Tensioni i ditëve të fundit ju ka kapur dhe juve. Çdo gjë bëhet me vrap dhe në rrëmujë e sipër. Mund të harroni një mik pa e telefonuar.



AKREPI

Punët, humori dhe dashuria sot janë në ekuilibër të plotë. Një ditë e mbushur me çaste gëzimi dhe qetësie që do ta shijoni në çdo çast.



SHIGJETARI

Nuk duhet që më të mëdhenjve në moshë t'ju vini re çdo gjë që thonë sot. Sa më tolerant të jeni aq më shumë do ta shijoni ditën.



BRICJAPI

Dita e sotme karakterizohet nga tone të larta humori dhe ju do të jeni në mes të një ambienti që e njihni mirë.



UJORI

Po mendoni që situata në të cilën ndodhni mund të ishte më e mirë, por ju kënaqeni edhe më pak, kështu që do ta shijoni çdo çast të ditës.



PESHQIT

Një dëshirë e madhe për të mos bërë asgjë dhe për të ndenjur të qetë. Ide brilante në mendje se si do ta nisni ditën dhe si do ta vazhdoni më tej.

Taylor Swifti i dhuron fanses 15 mijë dollarë



Më 1 tetor Sadie Bartell ka postuar një status në "Twitter" ku u kërkonte ndihmë ndjekësve të vet. Ajo kërkoi ndihmë monetare për nënën e cila kishte rënë në koma prej tre vjetësh. Familja kujdesej për të dhe e

mbante në shtëpi pa ia shkëputur aparaturat. Taylor Swift, këngëtarja e njohur në gjithë botën, e kishte parë postimin e saj dhe i kishte dhuruar vajzës 15 500 dollarë. Swifti i dërgoi të ardhurat në llogarinë e vajzës në emrin e saj.

Nicki Minaj paditet për shkelje të së drejtës së autorit



Reperja Nicki Minaj duhet të kërkojë falje për këngën 'Sorry'. Pasi ajo është paditur nga këngëtarja Tracy Chapman për shkelje të së drejtës së autorit lidhur me këngën. Chapman pretendon se 'Sorry' përmban tekstin

dhe melodinë vokale të këngës së saj "Baby, Can I Hold You", që Nicki i ka përdorur pa leje. Në padinë e siguruar nga "CNN", Chapman pretendon se Minaj dhe përfaqësuesit e saj kërkuar leje në qershor 2018 për përdorimin e këngës.



Gigi Hadidi shkëlqen e veshur me kostum të bardhë

Supermodeluesja e famshme Gigi Hadid ka shkëlqyer e veshur me një kostum të bardhë elegant teksa po merrte pjesë në The Tonight Show në Nju Jork. Ajo disa ditë më parë ka

konfirmuar pjesëmarrjen edhe këtë vit në shfaqjen më të njohur në botë, Victoria's Secret. Modeluesja 23-vjeçare u tregua e guximshme edhe me buzëkuqin e ndezur i cili i përshtatej me veshjen.

Dalje e rrallë në publik e binjakeve të njohura

Mary-Kate dhe Ashley Olsen janë fotografuar së bashku pas një kohe të gjatë larg syrit mediatik, por ato ishin të panjohura natën e fundit. 32-vjeçarët binjake u panë në Nju Jork. Fotografitë e fundit të binjakeve janë nga viti 2018 gjatë muajit qershor.





Autor: GAZMEND MORINA	IRNOSET (bised.)	CIGAN ENDACAK, ARIXHI	FABRIKAT E MEKANIZU-ARA	KRAHINË NË SHQIPËRI	SKUADËR	LLOJ VETURE JAPONJEZE	EPOKA E RE	STADIUM I MADH NË BRAZIL	EMPOLI, GROSETO	NOTË MUZIKORE	BASHKIM QELIZASH TË NJËLLOJTA (shq.)
KRYETAR I NJË MANASTIRI TË MURGJVE ORTODOKSË							FUTBOLLISTI LIONEL				
RRUSH KO-KËRRGJATË, I KUQ A I ZI DHE ME CIPË TË TRASHË							NIS TË ZBARDHË DITA BEKIMI				
E MBARUAR, E PËRFUNDUAR									DY BASHKË-TINGËLLORE DREJTIM		
NGJYRË E FYTYRËS					PRIMITIV AKTORJA AMERIKANE PORTMAN (shqip.)					INTER LLOJ BIME QË PËRDORET SI ERËZ PËR GJELLË	
EPOKA E RE	LOCAL AREA NETWORK AKTORJA JONË IRENA					SMIRË KRIJIM, GJË E SHPIKUR NGA MENDJA					RITUALET
BASHKËT.		GOTË PREJ BAKRI KËNGËTARE E NJOHUR AMERIKANE					HEROI MEHA FUTBOLLISTI HOLANDEZ RAFAEL ... DER VART				
ALYSSA MILANO					PJESË E EPËRME E DHOMËS SHARRËZ				GABRIEL IGLESIAS FUTBOLLISTI ARGJENTINAS HAVIER		
EPOKA E RE	PJESË E MEKANIKËS QË STUDION LIGJET E LËVIZJES SË TRUPAVE	FAZA	KËNGËTARJA ZYMERI	ISH ATLETJA E SHQUAR MERLIN	NORA ISTREFI	FATKEQËSI E MADHE, KOB (shq.)			NITROJEN ZAKON		
QENIE MBINJ-ERËZORE ME FUQI TË FSHEHTË (mit.)						KËNGËTARJA NË FOTO TAHIRI				NËNË (turq.) ISMET TOTO	
PARA TË NËNTIT						VLERËSIM ME NOTË SHTET I MADH NË AMERIKËN VERIORE		LETRARI MEHMETI NGATËRRESA E MADHE		TREVISO BËRJE MË I RI	
SHEGA					SHTET I MADH NË AZI KUNDREJT BASHKËTIN-GËLLORE		PA U NXITUAR, NGADALË (turq.)	I SHËMTUAR (bised.) HARK, KTHESE			BURG KU MBAHESHIN DËNIMET E RËNDA
VËLLAI I MADH				ZENEL AHMETI VIJË E PËRKULUR SI LAK (gjeom.)		JETËSHKR-IMET BABAI				"... TAK" DASH QË E KA TURIRIN TË BARDHË E ME PIKLA SI TË KUQE	
MARK ANTONI			LUMË NË SHQIPËRI KËNGËTARI SHAQIRI (shq.)				VEZAK		BALTË E QULLËT, GJANË (shq.) TROPOJA		
ZANORE	FLEGËR EMËR MASHKULLI TURK (shq.)						I GJYMTI DHËNIE E NJË ÇMIMI TË LARTË			"IZMIR" KOPJIMET	
RRËSHQANOR I MADH (zool.)							BASHKËT. RRËMUJË	JEMENI DY BASHKË-TINGËLLORE	HUMORIST I YNI MUAJ I VITIT		
BEND I YNI MUZIKOR						ALI ASLLANI RAST		BANJË ALLATURKA ENDE			MOLDE QYTET SHQIPTAR NË MAL TË ZI
EPOKA E RE	GËZIM I MADH QË ËSHTË LARA-LARA NË TRUP					ISH FUTBOLLISTI FRANCEZ LILIAN VISHET ME BAR			KËNGËTARJA TAKE AGJENCIONI EVROPIAN		
BANORE E LABËRISË					PRESIDENTI AMERIKAN OBAMA KËNGËTARE E NJOHUR Ë SHQIPËRI			ADEM JASHARI RAMADAN AVDIU		HISTORIANI ROMAK LUKRECI ARKË SHUMË E VOGËL PREJ DRURI	
KYÇI				PRINCIPIELE DJALI KUNDREJT PRINDËRVE (pashq.)					LLOJ PEME TROPIKALE (pashq.) TENISTJA CLIJSTERS		SHTEG
RIFAT ISMAJLI			ELEMENT KIMIK BELGJIKA, AUSTRIA				NËNË "MESINA"		BIXHOZ RENS ISTVUD		
ZANORE		DY DUKURI QË KANË NDËRMJET TYRE LIDHJE TË DYANSHME LECCE					RESHAT ARBANA TRIERI	KALORËS MESJETAR BASHKËT.			
VEGËL MUZIKORE								KUFIZIM			

Murdoch, ja thesari i gjashtë fëmijëve të super-miliarderit

Pas shitjes së Foxit në Disney, bijtë e sipërmarrësit të mbiquajtur “peshkaqeni”, do të marrin dy miliardë dollarë secili

Dy miliardë dollarë secili. Kjo është mënyra sesi po arkëtohen lekët për secilin prej gjashtë fëmijëve të Rupert Murdoch, pas ndarjes së perandorisë së medias dhe shitjes së aktiviteteve argëtuese në Walt Disney. Pjesë të barabarta për fëmijët e parë; për Lachlan, James dhe Elizabeth, tre djemtë e gruas së tij të dytë Anna; dhe më në fund për Grace dhe Chloe, dy vajzat, ende adoleshente, që i ka nga gruaja e tretë,

61% të mbetjeve të TV kabllor. Nëse të pasurit janë gjithnjë e më të bindur se pasuria nuk duhet të dorëzohet por të fitohet, nga Bill Gates në Warren Buffet, nga Mark Zuckerberg në Sting, në këtë kategori sigurisht nuk përfshihet Rupert Murdoch, 87 vjeç, katër herë i martuar e fundit në vitin 2016 me Jarry Hall, 62 vjeç, ish-modelle dhe ish-gruaja e yllit të rokut Mick Jagger (me të cilën ka 4 fëmijë).



dhe Azinë, duket se është projektuar drejt një të ardhmeje të ndryshme, duke qenë se ai është renditur si kandidati i

News Corp-it të babait në vitin 2011, shitje që ka ngritur shumë polemika dhe akuza për nepotizëm.

Grace dhe Chloe janë shumë të reja dhe nuk kanë të drejtë të votojnë për vendimet: për interesat e tyre ekonomike ata shikojnë njerëzit e zgjedhur nga babai Rupert dhe nëna e tyre Wendi (një ishte Ivanka Trump, para se të largohej për të shmangur konfliktet e interesit pas zgjedhjes së babait Donald në presidencën amerikane).



preferuar për të zëvendësuar Elon Musk në presidencën e Tesla (tashmë pjesë e bordit). Vajza më e madhe, Prudence, e lindur në vitin 1958, është përjashtuar: ajo jeton në Australi dhe kurrë nuk ka pasur ndonjë rol operativ në grupin e familjes. Elizabeth, 50 vjeç, ka hyrë dhe ka lënë biznesin e familjes ashtu siç i pëlqen, por ajo ka fituar para në botën e theme-limit të medias, në vitin 2001, Shine, kompania britanike e prodhimit televiziv që më pas iu shit me një çmim të lartë

Alternativa? Të bësh si Bill Gates, i cili mendon se është e mjaftueshme t'u japësh fëmijëve “një edukim të mirë dhe para të mjaftueshme” për të mos pasur vështirësi financiare. “Duke u dhënë fëmijëve një shumë të madhe parash, nuk është se po u bëni favor. Do të shtrembëronte gjithçka që mund të bënin, ndërkohë që po ndërtojnë rrugën e tyre”, thotë themeluesi i Microsoft. Rupert Murdoch pa dyshim nuk pajtohet.

(gazeta-Shqip.com)

Wendi Deng.

Ajo që i bën llogaritë është Financial Times, që ka 17% të kapitalit që kontrollon nga besimi i familjes. Ky investim është me vlerë rreth 12 miliardë dollarë në dritën e ofertës prej 71.5 miliardë dollarë që Disney po përgatitet të paguajë për aktivitetet e shekullit të 21-të, duke përfshirë filmat, kanalet kablore dhe rrjetin aziatik të yjeve Star.

Por nuk përfshin aksionet e familjes Murdoch në News Corp, grupin redaktues që kontrollon, ndër të tjera, Wall Street Journal dhe dy gazetat e Londrës “The Times” dhe “The Sun”; as New Fox, kompania e lindur nga ndarja nga Century Fox që ruan kanalin amerikan të lajmeve Fox News. Brenda ka 39% të Sky që Murdoch, së bashku me Disney, ka rënë dakord të shesë në Comcast, pasi ka humbur ankandin për

Për djemtë e tij, manjati australian me pasaportë amerikane jo vetëm që zgjodhi të linte një pasuri të madhe, por gjithashtu i donte ata nga ana e tij, duke u ofruar atyre rolet menaxheriale të nivelit më të lartë në menaxhimin e perandorisë familjare. Kjo ndodhi në të kaluarën, dhe kjo ndodh edhe sot. Pas riorganizimit, Murdoch dhe djali i tij më i madh, Lachlan, 46 vjeç, do të vazhdojnë të punojnë së bashku: djali plangprishës (në vitin 2005 Lachlan kishte lënë çdo pozitë në grupin e familjes dhe ishte kthyer në Australi, duke krijuar vend për djalin e dytë James) u emërua president dhe drejtor ekzekutiv i New Fox, ku Rupert është bashkëpresident.

James, 45 vjeç, drejtor ekzekutiv aktual i Century Fox dhe ish-numri një i News Corp dhe Sky në Europë (përfshirë Italinë)



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

CHELSEA - BATE BORISOV

1

BESIKTAS - GENK

1

AC MILAN - REAL BETIS

1

Maliqi: Do të ndryshojë renditja



Feronikeli, Prishtina dhe Llapi janë të parat në tabelën e elitës së futbollit, por Behar Maliqi është shprehur i bindur se renditja do të ndryshojë me kalimin e xhirove. "Nuk mund të themi se tri skuadrat e para janë në garë për titull dhe të tjerat jo, pasi kampionati është i gjatë dhe klubet do të kenë luajtje të formës. Ne e kemi përjetuar një gjë të tillë, pasi jemi pa sulmuesin kryesor, Ahmet Januzi, që është i lënduar, kurse disa ndeshje ka munguar edhe Mentor Zhdrella, pra edhe skuadrat e tjera do të kenë probleme me lëndime apo rënie të formës", ka thënë Behar Maliqi

EPOKA E RE **Veton ZYMBERI**

PRISHTINË, 24 TETOR - Një nga lojtarët më të mirë në futbollin e Kosovës, Behar Maliqi, i cili këtë edicion po e djersit fanellën e Llapit nga Podujeva, ka thënë të mërkurën për "Epokën e re" se renditja e skuadrave në tabelën e IPKO Superligës në futboll do të ndryshojë, pasi kampionati është i gjatë dhe skuadrat do të kenë "turbulenca". "Nuk mund të themi se tri skuadrat e para janë në garë për titull dhe tjerat jo, pasi kampionati është i gjatë dhe skuadrat do të kenë luajtje të formës. Ne e kemi përjetuar një gjë të tillë, pasi jemi pa sulmuesin kryesor, Ahmet Januzi, që është i lënduar, kurse disa ndeshje ka munguar edhe

Mentor Zhdrella, pra edhe skuadrat e tjera do të kenë probleme me lëndime apo rënie të formës", ka thënë Maliqi. Skuadra e Llapit ndeshjen e fundit në elitë e luajti baras në derbin ndaj Trepçës '89 (1-1), kurse përballjen e radhës e zhvillon ndaj Drenicës në Skenderaj. Maliqi e njejtë mjaft mirë skuadrën kuqezi, prandaj e ka vlerësuar si kundërshtar të vështirë për secilën skuadër që përballlet me të, përfshirë edhe Llapin. "Si Trepça '89 ashtu edhe Drenica aplikojnë një lojë të mirë dhe janë kundërshtarë shumë të vështirë për t'u mposhtur. Lojën e parë e kemi humbur ndaj tyre dhe nuk mendojmë për hakmarrje, por do të shkojmë ta luajmë lojën tonë dhe ta marrim maksimumin

nëse mundemi", ka shtuar Maliqi. Skuadra e Llapit është një nga ato skuadra që ka pësuar ndryshime në shtabin teknik, ku në vend të Bylbyl Sokolit të shkarkuar është emëruar Bekim Shotani. Lidhur me këtë lëvizje, Maliqi është treguar mjaft i matur, duke thënë se: "Ndryshimet në shtabe teknike ndodhin në çdo klub në botë dhe çdo trajner e ka filozofinë e lojës. Në futbollistët duhet t'i përshtatemi sistemit që kërkon trajneri dhe ta japim maksimumin si në stërvitje, po ashtu edhe në lojë". Skuadra e Llapit prej njëmbëdhjetë ndeshjeve të zhvilluara ka grumbulluar 20 pikë, duke regjistruar gjashtë fitore, dy barazime dhe tri humbje.

SHKURT

KB Rahoveci reagon pas dënimit të FBK-së

Federata e Basketbollit e Kosovës (FBK) ka shqiptuar gjoba prej 675 eurosh për KB Rahovecin, pas ngjarjeve të fundit që kanë ndodhur në ndeshjen ndaj KB Ponte Prizreni. Vendimi, sipas FBK-së, është i bazuar në raportimet e delegatit, ku përfshihen edhe hedhjet e gjëseneve në parket. Bordi i KB Rahoveci ka kërkuar nga adhuruesit të mos përsëriten sjelljet e tilla në ndeshjet e ardhshme, pasi ato e dëmtojnë klubin. "Bordi i KB Rahoveci ka diskutuar lidhur me këtë vendim, ndërsa apelon te të gjithë që të mos përsërisin raste të tilla të cilat mund të sjellin dëm edhe më të madh për klubin, i cili edhe ashtu po përballlet me probleme të shumta, duke u nisur nga ato financiare e deri te zhvillimi i ndeshjeve që duhet t'i bëjë çdoherë jashtë Rahoveci. Bordi kupton frustrimin që mund të kenë basketbolldashësit ndaj vendimeve të referëve, por hedhja e gjëseneve nuk mund ta zgjidhë këtë problem, andaj apelojmë që të hiqet dorë nga veprime të tilla", thuhet në njoftimin e KB Rahoveci.

Kamberi, afër rangersave

Sulmuesi Florian Kamberi mund të largohet nga skuadra e Hibernianit. Por, jo edhe të largohet nga Skocia. Interesim për Kamberin ka shprehur skuadra e udhëhequr nga Steven Gerrard, Glasgow Rangers, ka njoftuar të mërkurën "rangersnews.uk". Pjesë e Glasgow Rangersit është edhe sulmuesi i kombëtares së Shqipërisë, Eros Grezda.

Cana: Kam nisur negociatat për blerjen e një klubi

Ish-kapiteni legjendar i Kombëtares së Shqipërisë, Lorik Cana, ka folur në lidhje me një kthim të mundshëm në futboll, por jo me një rol futbollist. "Kam nisur negociatat për blerjen e një klubi, kështu që nuk mund të flas për të ende. Ky është një klub që nuk është pjesë e njërës nga pesë ligat më të mëdha evropiane, por do të jetë një vend i mirë për të krijuar përvojë. Më duhet të shoh nëse e pëlqej, nëse ndihem mirë në këtë rol dhe nëse mund të mendoj të shkoj në një klub më të madh. Më tepër synoj drejtimin sportiv, ose në përgjithësi drejtimin e përgjithshëm. Për të stërvitur, kurrë nuk më ka tërhequr. Drejtimi, me të vërtetë që më intereson", ka thënë Cana.

Bonucci: Synojmë finalen e Ligës së Kampionëve

Mbrojtësi i rikthyer në skuadrën e Juventusit, Leonardo Bonucci, ka bërë me dije se "Zonja e Vjetër" e synon kualifikimin deri në finale të Ligës së Kampionëve. Juve e mposhti Manchester Unitedin me rezultat 0-1, në ndeshjen që u zhvillua në "Old Trafford". "Ne duam të dominojmë në Ligën e Kampionëve. Deri më tani, kur janë luajtur gjysmat e ndeshjeve në grupe, e kemi arritur diçka të tillë me sukses. Fitorja me Unitedin ishte e merituar. Ne duam të arrijmë deri në finale, e dimë se është e vështirë, por kam besim se ne do t'ia arrijmë", ka deklaruar Bonucci.

Sot ndeshja FC "Prishtina" - AVK "Bardhosh Gërvalla"

PRISHTINË, 24 TETOR - Fituesi i Digital Kupës së Kosovës, FC Prishtina dhe fituesja e Kupës së Kosovës nga Diaspora, AVK "Bardhosh Gërvalla" nga Ludwisburgu do të përballen sot (e enjte) në kuadër të Superkupës së Kosovës - Diasporë. Kjo ndesh-

je zhvillohet në stadiumin "Fadil Vokrri" në Prishtinë nga ora 13:00. "Tradita e zhvillimit të këtyre ndeshjeve po vazhdon dhe kjo do të vazhdojë nën përkujdesjen e FFK-së. Mbase ka një karakter më shumë sesa sportiv, sepse kjo na bën ta njohim edhe më shumë

njëri-tjetrin. Besoj se adhuruesit do ta kenë rastin të shohin një ndeshje të mirë, ndërsa ju dëshiroj të dy klubeve një garë korrekte në frymë sportive dhe vëllezërore", ka thënë zëvendëssekretari i përgjithshëm i FFK-së, Arianit Ahmeti.



Sharapova synon Olimpiadën

MOSKË, 24 TETOR - Tenistja ruse Maria Sharapova synon pjesëmarrjen në Lojërat Olimpikë "Tokio 2020" dhe për këtë arsye synon të rikthehet në ekipin kombëtar. Lajmin e ka konfirmuar presidenti i Federatës Ruse të Tenisit,

Shamil Tarpishev. "Për fat të mirë, Maria është pranë rikthimit në kombëtare. Ajo do të nisë së shpejti përgatitjet për sezonin e ri. Maria synon të luajë në Olimpiadë, ndaj për të pjesëmarrja në kombëtare është e rëndësishme", ka

thënë Tarpishev, duke shtuar: "Ne e vlerësojmë shumë faktin që Sharapova është sërish e gatshme ta ndihmojë ekipin kombëtar, pasi është një teniste që ka dhënë shumë për ne". Me shumë gjasa, Maria Sharapova do të jetë në

fushë edhe në turneun e Hopman Cup, që zhvillohet në Australi më 29 dhjetor - 5 janar, turneu i parë ekipor i sezonit të ri. Tenistja ruse ka fituar vetëm një medalje argjendi në Olimpiadën e "Londër 2012".



Arsenali për histori ndaj Sportingut

LISBONË, 24 TETOR - Sportingu i Lisbonës do ta presë Arsenalin në javën e tretë të Grupit E të Evropa Ligë sot (e enjte) nga ora 18:55. Të dyja këto skuadra kryesojnë grupin me pikë të barabarta pas dy ndeshjeve të para, me anglezët që mbajnë vendin e parë për shkak të diferencës më të mirë të golave. Portugezët kanë marrë dy fitore dhe katër humbje në ndeshjet e luajtura që nga sezoni 2009/10 kundër skuadrave të Premier Ligës. Të dyja ato fitore janë regjistruar në Portugali. Sportingu e ka nisur aventurën në Evropa Ligë me një fitore 2-0 kundër Qarabagut në Lisbonë, e pasuar me një sukses 2-1 në fushën e Vorskla. Arsenali, nga ana tjetër, ka mundur 4-2 Vorskla në "Emirates" para se të merrte një fitore 3-0 në Qarabag. Të dyja këto ekipe pritet t'i fitojnë ndeshjet e kthimit që do të luajnë kundër Qarabagut dhe Vorskla, me dy ndeshjet që do të luhen në Lisbonë dhe Londër që pritet ta vendosin fituesin e këtij grupi. Këto dy skuadra janë ndeshur për herë të fundit në sezonin 1969-70, në atë që njihet në atë kohë si Kupa e Panairëve. Ndeshja e luajtur në Lisbonë është mbyllur në barazim pa gola, ndërsa Arsenali ka fituar 3-0 në "Highbury". Gjithsesi, Arsenali nuk ka fituar kurrë si mysafir kundër një ekipi portugez (3 barazime, 3 humbje), duke humbur tre të fundit. Por Unai Emery ka humbur vetëm një nga 20 ndeshjet që ka drejtuar në fazën me grupe të Evropa Ligës (11 fitore, 8 barazime).



Arsenali ka shënuar golin e parë në 8 nga 9 ndeshjet e fundit që ka luajtur në të gjitha kompeticionet.

GRUPI A 18:55 AEK Larnaca - Ludogorets Razgrad 18:55 Zuerich - Bayer Leverkusen	GRUPI G 21:00 Rangers - Spartak Moscow 21:00 Villarreal - Rapid Wien
GRUPI B 18:55 Leipzig - Celtic 18:55 Salzburg - Rosenborg	GRUPI H 21:00 Eintracht F. - Apollon Limassol 21:00 Marseille - Lazio
GRUPI C 18:55 Kopenhagen - Slavia Prague 18:55 Zenit - Bordeaux	GRUPI I 21:00 Besiktas - Genk 21:00 Sarpsborg - Malmoe
GRUPI D 18:55 Anderlecht - Fenerbahce 18:55 Spartak Trnava - Dinamo Z.	GRUPI J 21:00 Sevilla - Akhissarspor 21:00 Standard L. - Krasnodar
GRUPI E 18:55 Qarabag - Vorskla 18:55 Sporting - Arsenal	GRUPI K 21:00 Jablonec - Astana 21:00 Rennes - Dynamo Kyiv
GRUPI F 18:55 Milan - Real Betis 18:55 Dudelange - Olympiacos	GRUPI L 21:00 Chelsea - BATE Borisov 21:00 PAOK - Vidi

Detroiti triumfoi në shtesë

DENVER, 24 TETOR - Denveri po kalon një moment të mirë në kampionat, duke korrur sot suksesin e katërt radhazi. Skuadra e Nuggetsit mundi 126-112 Sacramento, në një takim të dominuar nga basketbollistët e Denverit. Tetë lojtarë të ekipit vendës realizuan mbi 10 pikë, çka tregon për forcën e kolektivitetit të skuadrës së Denverit, ku më të mirët ishin Murray me 19 pikë e Harris me 18. E pamposhtur në kampionat edhe skuadra e New Orleansit, me tri fitore në po kaq takime të luajtura. Pelicansi fitoi 116-109 ndaj Clippersit, ndeshje që u përmbys në favor të miqve në pjesën e dytë. Për Clippersin, dyshja Harris - Gallinari realizoi 50 pikë, por që s'mjaftuan për ta evituar humbjen, ndërsa për miqtë u dallua Davis me 34 pikë e 13 rebaunde, raporton



"Telesport". Pas kohës shtesë fiton ekipi i Detroitit, që mundi 133-132 Philadelphia, ndeshje emocionuese dhe dramatike deri në sekondën e fundit. Një ndeshje fantastike e Blake Griffinit, që realizoi 50 pikë e 14 rebaunde, duke i bërë të pavlefshme 33 pikët e 11 rebauudet e Emiid

për vendësit. Për Detroitin sukcesi i tretë radhazi, ende i pamposhtur këtë sezon.

REZULTATET

Philadelphia - Detroit 132-133
Clippers - New Orleans 109-116
Denver - Sacramento 126-112

SHKURT

Mourinho: Juventus ishte në një nivel tjetër

Jose Mourinho e ka pranuar se Juventus ishte në një nivel tjetër sa i përket cilësisë, stabilitetit dhe përvojës përballë Manchester Unitedit. "Kundërshtarët kanë pasur cilësi të madhe. Ndonjëherë njerëzit e shikojnë Cristiano Ronaldo ose Dybalan, por në një ekip të madh ju duhet ta shihni edhe Giorgio Chiellinin dhe Leonardo Bonuccin. Mendoj se Juventus është lloj i ekipit që kur ata janë përpara, është shumë e vështirë t'i ndalësh. Të gjithë u përpoqën, të gjithë ishin të fortë mendërisht për të provuar deri në fund. Ishte një ndeshje vërtet e vështirë për ne. Mendova se mund të merrnim diçka, por nuk ishte e mundur", ka thënë Mourinho. "Juventus është një nivel tjetër i cilësisë. Unë duhet të jem i singertë. Niveli i cilësisë, stabilitetit, përvojës, njohurisë. Baza e ekipit që ata kanë janë Bonucci dhe Chiellini. Ata janë baza që i lejon ekipin të luajnë me liri në sulm. 'Humbni topin, nuk ka problem, ne jemi këtu', ka shtuar Mourinho.

Alonso vazhdon me Chelsean

Chelsea ka blinduar mbrojtjen. Blutë e Londrës kanë zyrtarizuar ditën e sotme rinovimin me Marco Alonso. Spanjollit ka nënshkruar një kontratë të re që do ta mbajë në Londër për pesë vjet. Sarri ka besim maksimal te mbrojtësi i majtë, pasi deri më tani ai ka luajtur nëntë ndeshje. 27-vjeçari është pjesë konstante e ekipit që nuk është mposhtur ende në Premier Ligë. Alonso mbërriti te Chelsea në 2016-n dhe u ble për 23 milionë euro nga Fiorentina, me kërkesë të Antonio Contes. "Jam i lumtur që do të vazhdoj të luaj në Londër. Luaj për një nga skuadrat më të mira në botë", ka thënë Alonso.

Marcelo, gazetarëve: Na kritikoni sepse jeni xhelozë

Sigurisht nuk është e rastësishme që ecuria më e keqe e Real Madridit në këtë sezon erdhi kur Marcelo nuk ishte në skuadër dhe braziliani arriti të shënojë në ndeshjen kur madrilenët iu kthyen fitoreve në ndeshjen kundër Viktoria Plzenit. Pasi arriti ta shënojë golin e dytë në dy ndeshje, braziliani i sulmoi gazetarët, të cilët kishin qenë mjaft kritikë drejt "Los Blancos", pasi që këta të fundit kishin mbetur pa fitore në pesë ndeshjet e fundit. "Është e vështirë kur nuk fiton, por ju flisni për krizë sikur të dëshironit ta lëndonit këtë skuadër. Të gjithë gazetarët tentojnë të na lëndojnë, ndoshta është për shkak të xhelozisë, sepse ju nuk dini të luani futboll", ka thënë Marcelo.

Verstappen: Dua të fitoj në Meksikë

Max Verstappen po kalon një çast shumë të mirë në Formula 1, prandaj kërkon në Meksikë fitoren e dytë sezonale. "Në Amerikë arritëm një rezultat disi të papritur. Pas problemeve ditën e shtunë në prova, fillimi i garës ishte fantastik dhe pas xhiros së parë e pashë veten në pesë vendet e para", u shpreh piloti holandez Max Verstappen, që u nis nga vendi i 15-të por, në fund, u renditi i dyti. Ky është podiumi i dytë radhazi për pilotin e Red Bullit, pas vendit të tretë në Japoni dy javë më parë dhe tashmë ai kërkon diçka më shumë nga gara e radhës në Meksikë. "Pas dy podiumeve është normale që të kërkoj një tjetër rezultat të mirë edhe në Meksikë. Madje synimi është fitorja, edhe pse mund të jetë e vështirë me Hamiltonin që kërkon fitoren dhe titullin. Jam i kënaqur me paraqitjen e deritanishme dhe rezultatet e arritura. Jemi të shpejtë dhe me pak fat e kujdes mund të korrin të tjera suksese këtë sezon", deklaroi piloti Max Verstappen, që këtë sezon ka korrur vetëm një fitore.



ОПШТИНА ГРАЧАНИЦА
KOMUNA E GRAÇANICËS
MUNICIPALITY OF GRACANICA



Drejtoria e administratës së përgjithshme dhe çështjeve kadrovike / Shërbimi për burime njerëzore dhe çështjet kadrovike

Duke u bazuar në Ligjin e Shërbimit Civil të Republikës së Kosovës L. NR. 03/L – 149 dhe në Rregulloren nr.02/2011 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, **Komuna e Graçanicës** shpall këtë:

KONKURS

KG7 - Drejtoria e Inspektionit

Titulli i vendit të punës: Inspektor i Mbrojtjes së Mjedisit

Numri i referencës: RN00003908

Niveli i pagesës: 407.55€

Qëllimi i vendit të punës

Mbrojtja e mjedisit

Detyrat Kryesore

1. Kontrollon dhe parandalon krijimin e deponive të egra
2. Kontrollon hedhjen e mbeturinave në natyrë
3. Kontrollon hedhjen e mbeturinave në shtetërit dhe brigjet e lumenjve, kanale dhe liqene
4. Kontrollon mirëmbajtjen e sipërfaqeve publike
5. Kontrollon përdorimin e resurseve natyrore, zbaton planet dhe masat për mbrojtjen dhe ruajtjen e mjedisit, shqipton masa të parapara me ligj
6. Kontrollon shkallën e kërcënimit të mjedisit, inspekon shkallën e ndotjes së ajrit
7. Punon në parandalimin e derdhjes së ujërave të zeza dhe industriale
8. Kryen edhe detyra tjera në përputhje me ligjin dhe rregullat sipas urdhërit të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë

Shkathësitë

1. Njohuri të mirë në kompjuter
2. Përparësi është njohja e gjuhëve që janë në përdorim zyrtar

Edukimi

1. Diploma universitare

Kualifikimi

1. Të ketë të kryer Fakultetin, drejtimi i mbrojtjes së mjedisit

Experienca

1. Përvojë pune së paku 3 vjet

Marrja dhe dorëzimi i aplikacioneve:

Komuna e Graçanicës – Shërbimi I Shkrimore dhe Arkivit, rruga Cara Lazara pn. Për informata të hollësishme mund të kontaktoni me: Sandra Stevic Stankovic, në tel: 049-357-200 ose përmes postës elektronike sandra.stevic@rks-gov.net prej orës 8:00 -16:00.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në një nga gazetaret ditore, përkatësisht nga data 25.10.2018. deri më 08.11.2018. Data 08.11.2018 konsiderohet data e mbylljes së konkursit.

Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim, nëse arrijnë brenda 4 ditësh, aplikacionet që arrijnë pas këtij afati dhe ato të pakompletuara nuk do të shqyrtohen fare.

Aplikacionit i bashkëngjiten kopjet e letërnjoftimit dhe dokumentacionit mbi kualifikimin dhe përvojën, që kërkohen për atë vend pune, për të cilin konkurrenca.

Kandidatët të cilën hyjnë në përzgjedhje të listës së ngushtë për intervistë do të informohen me telefon, në afat ligjor dhe kandidatët të ftuar duhen pa tjetër të sjellin dokumentet origjinale për shqyrtim para komisionit për intervistë.

Periodha e emërimit- Deri tek kthimi i nënpunësit i përhershëm.

Shërbimi civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.



ОПШТИНА ГРАЧАНИЦА
KOMUNA E GRAÇANICËS
MUNICIPALITY OF GRACANICA



Одељење за општу администрацију и кадровска питања / Служба за људске ресурсе и кадровска питања

На основу Закона Бр.03/Л-149 о цивилној служби Косова и Уредбе бр. 02/2011 за процедуре регрутирања цивилне службе Косова, **Општина Грачаница** објављује следећи:

KONKURS

KG7 – Одељење за инспекцију

Титула радног места: Инспектор за заштиту средине

Бр. препоруке: RN00003908

Ниво плате: 407.55€

Сврха радног места

Заштита животне средине

Главне Дужности

1. Контролише и сузбија дивље депоније
2. Контролише одлагања отпада у корита и обале река, канала и језера
3. Контролише одлагање отпада у природу
4. Контролише одржавање јавних површина
5. Контролише степен угрожавања животне средине, контролише степен загађења ваздуха
6. Контролише употребу природних ресурса, спроводи планове и мере заштите и очувања животне средине, изриче законом прописане мере
7. Ради на сузбијању изливању отпадних и индустријских вода
8. Обавља и друге послове у складу са законом и правилима по налогу непосредног руководиоца

Врлине

1. Добро познавање рада на рачунару
2. Познавање језика у службеној употреби

Образовање

1. Универзитетска диплома

Квалификације

1. Завршен факултет, смер заштита животне средине

Искуство

1. Радно искуство најмање 3 године

Узимање и предаја пријава:

Општина Грачаница – Служба писарнице и архиве, улица Цара Лазара бб. За више информација можете ступити у контакт са: Sandra Stevic Stankovic, на тел: 049-357-200 или путем е-mail sandra.stevic@rks-gov.net од 8:00 -16:00.

Конкурс остаје отворен 15 дана од дана од објављивања у једним од дневних новина, односно од 25.10.2018. до 08.11.2018. Дан 08.11.2018. се сматра закључним даном конкурса.

Пријаве прослеђене поштом које носе жиг са задњим датумом за пријаву-сматраће се валидним и узимаће се у обзир за разматрање уколико стигну у року од 4 дана, пријаве које буду стигле након овог рока као и некомплетне пријаве неће се разматрати.

Пријави приложити копију личне карте и документације о квалификацији и искуству за радно место за које се конкурише. Кандидати који уђу у ужи избор биће обавештени за интервју од стране персонала писмено или телефоном у законском року, и позвани кандидати треба да понесу оригинална документа ради провере пред комисијом за интервјуисање.

Период именованња: До повратка стално запосленог

Цивилна служба Косова је на услузи свим грађанима Косова и радо очекује пријаве од жена и мушкараца из свих заједница на Косову.



SHPALLJE PËR VEND TË LIRË TË PUNËS

Titulli: Zyrtar për Analiza

Divizioni: Letrat me Vlerë

Departamenti: Menaxhimi i Mjeteve

Niveli i gradës: 6

I raporton: Udhëheqësit të Divizionit të Letrave me Vlerë

Lloji i punës: Me kontratë të punës me kohë të caktuar 1 vjeçare

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Analiza e aktiviteteve të tregtimit të Letrave me Vlerë të emtuara nga Qeveria;
- Shqyrton e paraqet ofertat konkurruese dhe jokonkurruese;
- Bashkëpunon me Njësinë e Borsheve në kuadër të Departamentit të Thesarit në aktivitetet e ndërlidhura me emetimin e Letrave me Vlerë të Qeverisë;
- Kalkulimi i normave të kthimit para ankandit/shqyrtimi i të gjitha çmimeve dhe normave të kthimit konkurruese dhe jo-konkurruese;
- Kontribuon në krijimin e procedurave dhe politikave për operacionet e Tregut Primar dhe Sekondar;
- Kordinon punët me Zyrën e Pasmë ("Back Office");
- Koordinon punën me zyrtarë përgjegjës të bankave komerciale lidhur me tregtimin e Letrave me Vlerë;
- Përgatitë analiza të tregut të parasë, rrezikut dhe performancës së bankave;
- Ndihmon në analizën e raporteve financiare të bankave me të cilat bashkëpunon BQK;
- Përgatitja periodike të komenteve mbi tregjet financiare, përgatitë ad hoc përmbledhjet në ngjarjet ekonomike.
- Përgatitja e raporteve ditore, javore dhe mujore për Komisionin e Ankandëve mbi Letrat me Vlerë të Qeverisë;
- Kalkulimi i normave të kthimit para ankandit/shqyrtimi i të gjitha çmimeve dhe normave të kthimit konkurruese dhe jo-konkurruese;
- Shqyrton çmimet, ofertat mbi aktivitetin e tregut sekondar;
- Pranon dhe asiston në analizat ditore të likuiditetit dhe informatat e siguruar nga akterë primar;
- Analizon raportet dhe kalkulimet para se të dergohen në Zyrën e Pasmë.
- Përgatit të dhëna statistikore dhe raporte analitike mbi operacionet e tregut primar dhe sekondar;

Njohuritë e kërkuara:

- Diplomë universitare në financa, banking apo fushë tjetër me përmbajtje të theksuar financiare dhe bankare;
- Preferohet diplomë master në ekonomi, financa, banking apo fushë tjetër me përmbajtje të theksuar financiare dhe bankare;
- Njohuri të avancuara mbi teorinë moderne ekonomike dhe financiare, si dhe mbi standardet dhe praktikat ndërkombëtare të menaxhimit të investimeve financiare;
- Rrjedhshmëri në gjuhën shqipe dhe/ose serbe;
- Njohuri të shkëlqyeshme të gjuhës angleze;
- Njohuri kompjuterike lidhur me analizat ekonomike dhe financiare.

Përvoja e kërkuar:

Preferohet përvojë pune, në fushën bankare, në analiza investive dhe financiare.

Kërkesa të posaçme:

- Aftësi të mira analitike, të gjykimit të pavarur dhe të zgjidhjes së problemeve;
- Vetëiniciativë, aftësi të mira të komunikimit, shkathtësi ndërpersonale dhe të punës ekipore.

Të gjithë kandidatët duhet të dërgojnë dokumentet e mëposhtme:

- Formularin zyrtar të BQK-së për aplikim;
- Letrën përcjellëse (motivuese) ku theksohet interesimi për këtë pozitë;
- Kopjet e diplomave, ndërsa diplomat e fituara jashtë Republikës së Kosovës duhet të jenë të njohura /nostrifikuara zyrtarisht nga ana e MASHT-it;
- Dëshmi mbi identitetin dhe vendbanimin e përhershëm në Kosovë;

Procedura e aplikimit:

- Afati i fundit për aplikim është **08 Nëntor 2018**.
- Aplikimi mund të bëhet online (<https://hris.bqk-kos.org>) përmes faqes zyrtare të BQK-së ose përmes arkivit të BQK-së, nr.22. Asnjë formë tjetër e aplikimit nuk do të merret parasysh.
- Formën e aplikacionit mund ta shkarkoni përmes faqes zyrtare : www.bqk-kos.org
- Dokumentacionet e pakompletuara nuk do të merren parasysh.**



OBAVEŠTENJE O SLOBODNOM RADNOM MESTU

Naslov: Službenik za analize

Divizija: Hartije od vrednosti

Departmana: Upravljanje sredstvima

Nivo stepena: 6

Izveštava: Rukovodiocu divizije za hartije od vrednosti

Vrsta posla: Sa radnim ugovorom sa ograničenim vremenom od 1 godine

Obaveza i odgovornosti:

- Analiza aktivnosti trgovanja hartijama od vrednosti koje izdaje Vlada;
- Razmatra i predstavlja konkurentne i ne konkurentne ponude;
- Sarađuje sa jedinicom duga u okviru Departmana za trezor u aktivnostima vezanim za izdavanje hartija od vrednosti Vlade;
- Izračunavanje stopa pre-aukcije / razmatranje svih cena i konkurentnih i ne konkurentnih stopa;
- Doprinosi uspostavljanju procedura i politika za operacije primarnog i sekundarnog tržišta;
- Koordiniše poslove sa Pozadinskom kancelarijom (podrške) ("Back Office");
- Koordinira rad sa odgovornim službenicima komercijalnih banaka u vezi sa trgovanjem hartijama od vrednosti;
- Priprema tržišnu analizu novca, rizika i performansi banaka;
- Pomaže u analizi finansijskih izveštaja banaka sa kojima sarađuje CBK;
- Periodična priprema komentara na finansijskim tržištima, priprema ad hoc rezimee ekonomskih događaja.
- Priprema dnevnih, nedeljnih i mesečnih izveštaja za Komisiji za aukcije hartija od vrednosti Vlade;
- Izračunavanje stopa pre-aukcije / razmatranje svih cena i konkurentnih i ne konkurentnih stopa;
- Razmatra cene, ponude za aktivnosti sekundarnog tržišta;
- Prihvata i pomaže u dnevnim analizama likvidnosti i informacijama koje pružaju primarni interesni akteri;
- Analizira izveštaje i proračune pre nego što ih dostavi Pozadinskoj kancelariji (podrške).
- Priprema statističke podatke i analitičke izveštaje o operacijama primarnog i sekundarnog tržišta;

Potrebna saznanja:

- Univerzitetska diploma iz finansija, banking ili druge oblasti sa značajnim finansijskim i bankarskim sadržajem;
- Poželjno je diploma master u ekonomiji, finansijama, banking ili druge oblasti sa značajnim finansijskim i bankarskim sadržajem;
- Napredna saznanja o modernim ekonomskim i finansijskim teorijama, kao i o standardima i praksama međunarodnog finansijskog upravljanja;
- Tečni govor na albanskom i/ili srpskom jeziku;
- Odlično saznanje na engleskom jeziku;
- Računarska saznanja u vezi sa ekonomskim i finansijskim analizama.

Radno iskustvo:

Radno iskustvo u oblasti bankarstva, investicionoj i finansijskoj analizi je poželjno.

Posebni zahtevi:

- Dobre analitičke veštine, nezavisnog rešenja i rešavanje problema;
- Samoinicijativa, dobre komunikacijske veštine, međuljudske veštine i timskog rada.

Svi kandidati trebaju dostaviti sledeće dokumente:

- Službeni obrazac CBK-a za apliciranje;
- Propratno (motivacijsko pismo), na kome se navodi interesovanje za ovu poziciju;
- Kopije diploma, dok diplome koje su dobivene izvan Republike Kosovo moraju biti službeno priznate/nostrifikovane od strane MONT-a;
- Dokaz o identitetu i stalnom boravku na Kosovu;

Postupak apliciranja:

- Posljednji rok za apliciranje je **08 Novembar 2018**.
- Aplikacija se može obaviti on-line (<https://hris.bqk-kos.org>) putem službenog veb-sajta CBK-a ili putem arhive CBK-a, br. 22. Nijedan drugi oblik apliciranja neće biti razmatran.
- Obrazac za apliciranje možete preuzeti putem službene stranice: www.bqk-kos.org

Nepotpune dokumentacije neće se uzeti u obzir.

Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898
Sallon Depilimi Lume's Details
lumesdetails
Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi



OFERTË PËR SHITJE TË SHTËPISË

Shitet shtëpia dykatëshe, me sipërfaqe prej 218 m², dhe trualli me sipërfaqe prej 410 m².

Shtëpia gjendet në Prishtinë, në lagjen "Aktash I", rr. "Ferhat Draga" nr. 1.

Procedura e transaksionit nga shitësi te blerësi bëhet pas nënshkrimit të kontratës së shitblerjes dhe pagesës së çmimit të kontraktuar, pastaj paluejtshmëria e përshkruar më lart kalon te blerësi.

Çmimi sipas marrëveshjes.

**Informata më të hollësishme
mund të merren në numrin e telefonit
001-347-331-8305 në Nju Jork, kurse në Prishtinë
në celularin 044-166-580.**

AUTOSHKOLLA "RITMO - L"

**Auto Shkolla
"RITMO - L"
Prishtinë**

**Eksperiencia jonë
- përfitimi i juaj.**

**Ju mirëpret:
Stafi i Auto Shkollës " Ritmo -L "**

Tel / kontakt:

044 248 173

044 200 604

044 375 333

Kërkesa për shprehje të interesit

Emri i shkollës: "Kadri Zeka"

Komuna: Kaçanik

Data: 25.10.2018

Numri i kontratës: 1/2018	Emri i kontratës:
ESIP/C1.3/027 – ESIP/SDG/027-CS/1.2	Trajnim: Zhvillimi i shkathtësive të mësimdhënies cilsore dhe ndërveprimet me kurrikulën

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e *projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit* (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe Shkollës "Kadri Zeka" Dubravë, Kaçanik.

Objekti i nën-komponentit 1.3. (GZSh) të projektit ESIP është forcimi i kapaciteteve të shkollave që financohen me fonde publike që t'i planifikojnë dhe t'i menaxhojnë burimet si dhe ta promovojnë angazhimin qytetar përmes pjesëmarrjes së mësimdhënësve, prindërve dhe komunitetit në planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e aktiviteteve të shkollës

Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi i shërbimeve të konsulentëve të nevojshme:

Trajnim: **Zhvillimi i shkathtësive të mësimdhënies cilsore dhe ndërveprimet me kurrikulën**

Kualifikimet e firmës konsulente:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e kontratave për ofrimin e shërbimeve të konsulentëve të natyrës së ngjashme në dy vitet e fundit;
- Përvojë në trajnimin dhe punën me personelin e administratës publike ose komunale
- Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.

Firmat konsulente të pranueshme do të vlerësohen dhe radhitën në listën e ngushtë në bazë të kërkesave kualifikuese si më lartë.

Firmat konsulente duhet të tregojnë se kanë në dispozicion staf profesional, përkatesisht trajnerë të certifikuar dhe me përvojë në ofrimin e trajnimeve për mësimdhënës në fushën e zbatimit të kurrikulës cilsore në mësimdhënie.

Kriteret e vlerësimit:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin dhe zbatimin e kontratave për ofrimin e shërbimeve të konsulentëve nga fusha e kurrikulës (40%);
- Përvoja specifike në ofrimin e trajnimeve të natyrës së ngjashme (40%);
- Disponueshmëria e personelit kyç profesional të kualifikuar për detyrat (20%)

Procesi i seleksionimit:

Aktiviteti i prokurimit të do të realizohet në përputhje me: Udhëzime: përzgjedhja dhe punësimi i konsulentëve nga huamarrësit e Bankës Botërore" të muajt janar 2011 dhe të rishikuara në korrik të vitit 2014, dhe me dispozitat e përcaktuara në marrëveshjen për financim, sipas përzgjedhjes të bazuar në metodën e Kualifikimeve të Konsulentëve (KK).

Firmat konsulente të interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhura të aplikojnë me Shprehjet e tyre të Interesit për shërbime konsulente në adresën: SHFMU "Kadri Zeka" në Dubravë, më së largu deri më **02.11.2018**

Firmat e interesuara të konsulentëve mund të marrin informacion shtesë ose Termat e Referencës të detajuar për këto detyra në adresën e shënuar më poshtë.

Detajet kontaktuese të shkollës:

Personi kontaktues: Tefik Vishi

Telefoni: 044/227732

E-maili: tefik.vishi@hotmail.com

Njoftimi për shprehje të interesit

Shfmu: Enver Topalli – Greme-Omuraj

Data: 25-10-2018

Emri i kontratës: Aplikimi i teknologji informative në mësimdhënie .

Numri i kontratës: ESIP/C1.3/013- ESIP/SDG/013-CS/1.5

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e *projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit* (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe Sh.f.mu "Enver Topalli" – Greme-Omuraj. Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi si në vijim i shërbimeve të nevojshme:

1. Përshkrimi i shërbimeve të nevojshme:

OJQ/Firmë të certifikuar për trajnime të mësimdhënësve në zbatimin e teknologji informative në mësimdhënie

2. Kriteret minimale për kualifikim të kontraktuesve që mund të aplikojnë janë:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e së paku 2 kontratave për ofrimin e shërbimeve të natyrës së ngjashme në dy vitet e fundit;
- Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.

3. Kontraktuesit e interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhur të aplikojnë me shprehjet e tyre të interesimit kundrejt termeve të referencës në adresën : **Shfmu "Enver Topalli" Greme-Omuraj Komuna Ferizaj më së largu deri 02 Nentor më 2018**

4. Termet e Referencës së bashku me afatet dhe kushtet e tjera, ku të gjitha janë të përgatitura në kuadër të një dokumenti të quajtur Ftesë për propozim do t'ia dorëzojë shkolla vetëm atyre konsulentëve potencialë që i plotësojnë kriteret. Konsulentet luten që t'i shkruajnë detajet kontaktuese me rastin e shprehjes së interesit.

5. Detajet kontaktuese të shkollës:

Personi kontaktues:

Arta Sejdiu.**Telefoni: 044 944 082.****E-maili: sejdliuartaa@gmail.com****>> SHPALLJE TË VOGLA <<**

► Azmir Duraku shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën SHME " Ymer Prizreni" Prizren

► Muhamed Kryezi shpall te pavlefshme diplomën SHMLT "11 Marsi" Prizren

► Ibush Veljii shpall te pavlefshme diplomën SHMLT "11 Marsi" Prizren

► Bashkëpronarja Vesna Grujic shet pjesën e vetë ideale në parcelën kadastrale P-70202018-00001K-0 Zona Kadastrale Gojbule Komuna e Zveçanit. Ftohen bashkëpronaret që nëse janë të interesuar për blerje të kësaj prone të lajmërohen te i autorizuari i saj Savic Dimitrije nga Zveçani.

► Urgjentisht kërkohet banesë me qira për një çift në Fushe Kosove. Banesa duhet te ketë një dhomë gjumi dhomë dite me kuzhine te jete e mobiluar, çmimi: 150-200 euro. Tel 044-741-155

► Epet lokali me qira në rrugën "B" me sipërfaqe prej 214 m2. Lokali është i përshtatshëm për çfarë do lloj veprimtarie. Informatat në tel: 045-660-118.

► Urgjentisht kërkohet banesë me qira ne Prishtine, për një qift me një fëmijë. Banesa duhet te ketë 1 dhomë gjumi dhomë dite me kuzhine. Po ashtu të jetë e mobiluar si dhe të jetë afatgjatë. Çmimi 200 euro. Tel: 044-741-155

► Shes Truallin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, truall frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.

Shes truallin prej 36 arë në fshatin Besi; 150 metra nga magjistralja Prishtinë-Besianë. Truall ka gjithë infrastrukturën e nevojshme dhe është shumë e përshtatshme dhe për banim kolektiv.
Tel. 044-413-197, wiber: 045-198-095.

► Shes Truallin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, truall frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.

► Lëshoj me qira banesën tri dhomëshe në Bregun e Diellit, mbropa konvikte të studentëve, kati VI- lifti funksional, e rinovuar komplet me të gjitha elementet, e mobiluar, ka nxejje qendrore. Banesa lëshohet vetëm për familjar, për banesë duhet të lehet edhe depozitë prej një qeraje. Çmimi 350 euro, tel: 049-400-958

► Agjencia për patundshmëri "SAZANI", kërkon për blerje dhe lëshojmë me qira: banesa, shtëpi, lokale, troje dhe toka. Ndërmjetësojmë me korrektësi si dhe shesim disa sosh. Numri kontaktues: 044-207-474.

Lëshoj shtëpinë me qira, e cila gjendet në lagjen e "Universiteti" përball rrugës B dhe përball marketit Viva Fresh Store. Shtëpia është 100 metra katror dhe e mobiluar. Është e përshtatshme për zyre dhe banim.
Numri kontaktues 049-574-169.

Lumë's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 687 898
Sallon Depilimi Lumë's Details
lumesdetails
Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

